

AGIM CERGA

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32

C 36

EPRË E FORTË

Novelë

8dH-32
C 36.

AGIM CERGA

ERË E FORTË

Novelë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Në atë kohë e shoqja e Palit, pasi kaloi një krizë aq të fortë, sa desh i lau hesapet me këtë jetë, dështoi. Kjo fatkeqësi e goditi rëndë Palin. Aq i madh ishte dëshpërimi, sa është për t'i besuar mendimit që ai nuk do të kishte vajtur deri në këtë shkallë sikur Maria, të cilën e donte me gjithë zemër, pasi të kishte lindur fëmijën, të vdiste.

Por shpresa, që fryn gjithmonë në zjarrin e dëshirave tona, bëri që Pali të mos e varte kokën. Ai ishte akoma i ri dhe jetën e kishte përpara...

Vitet e rinisë kaluan si një èndërr, shpresa u dogj dalngadalë dhe në kokën e tij ra hiri i mërzisë.

Sikur atyre viteve të mos kishin ndodhur ngjarje të mëdha, Pali do të kishte vazhduar ta shëtiste Marien nga një derë kishe, në tjetrën, nga një manastir, në tjetrin... Por e ndërprenë këtë lëvizje të dëshpëruar, se midis tymit të shtëpive e arave që digjeshin, midis breshërisë së plumbave, topave, gjëmimit të luftës, midis plagëve e dhembjeve të mëdha të Shqipërisë, dhembja e tij për të pasur një fëmijë ishte tepér-tepér e vogël.

Pali do të kishte dalë vetë partizan, sikur vëllai i madh, punëtor në gurore, të mos qe treguar më i gatshëm. Ai i kishte lënë në shtëpi gruan dhe dy fëmijët, djalin 3-vjeç dhe vajzën 4-muajshe.

Pas një viti erdhi lajmi se i vëllai kishte rënë heroin-kisht. E kunata qëndroi edhe dy javë, pastaj u bë gati të shkonte në shtëpinë e t'et.

Atë mëngjes, kur do të nisej për udhë, ajo pa Palin që kishte marrë pas shtëpisë Dinin dhe diç po i thoshte.

Të dy po qeshnin me të madhe. Ishte për t'u çuditur se në ato çaste ngjanin sikur lozni, tamam siç lozin fëmijët.

Por midis gëzimit të tyre u fut si majë thike, befas, fjala ndarje. E éma, që kishte hipur mbi mushkë, e thirri Dinin të vinte me vrap.

Dini mbeti si i ngrirë.

— Hajde, Dini... Kemi për të bërë goxha udhë...

Dini u nis drejt s'ëmës, po Pali i thirri nga pas:

— Dini!

Ai u kthye dhe u lëshua me vrap drejt tij. U përqafuan fortë, duke u dridhur, zunë të qanin kokë më kokë.

Kunata mbeti e habitur. Gjatë tërë kësaj kohe ajo e kishte vënë re sa shumë e donin Dinin Maria dhe Pali, po kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend se ai, goxha burrë, me flokë e mustaqe të bardha, me trupin të lartë deri te trarët, me ata sy të mëdhenj, gjithmonë të trishtuar, mund të qante si fëmijë. «Çudi, sa shumë që e do», tha ajo me vete dhe u rrëqeth. Kjo ishte me të vërtetë e habitshme. Kur i pat ardhur lajmi për të vëllanë që kishte rënë dëshmor, ndërsa priste dhe përcillte njerëzit që vinin ta ngushëllonin, ai qëndroi si një copë shkëmb, pa derdhur as një pikëz lot, dhe ja, tanë, përkurgjë qante si fëmijë.

Pastaj ata u nisën.

Dhe shtëpia e Palit mbeti e shkretë.

Burrë e grua hanin, punonin, shtriheshin të flinin, gati pa shkëmbyer fjalë, në një heshtje të zymtë, sikur i mbanin mëri njëri-tjetrit për diçka që nuk e thoshin.

Një ditë, kur po rrinin në hijen e dardhës, papritur Pali ngriti kokën, e pa Marien në sy dhe i tha:

— Po... po...

Maria u kapërdi dhe e pyeti:

— Kur do të nisesh?

Pali uli sytë dhe, duke vështruar majat e opingave,
u përgjigj:

— Them të nisem nesër...

— Nisu, Pal, nisu... që me sabah... Zoti e bën të
mbarë!

Në mëngjes, pa gdhirë, ai u nis për udhë. Në darkë
u kthye me Dinin, hipur mbi kalin e bardhë që ai e don-
te aq shumë. Maria i priti te pusi i fshatit, e mori djalin
në krah dhe e shtrëngoi fort e fort...

Nuk dihet nëse dashuria e pleqve e rriti shpejt dja-
lin, apo gjëzimi fëmijnor i përtériu pleqtë.

Sa mbushi 18-vjeç, Dinin e martuan. Thonë se Pali
bëri goxha dasmë, theri viçin... thonë se ahengu zgja-
ti disa ditë e net...

Nusja doli e bukur, aq sa plaka bënte shenja fshe-
hurazi mos e merrnin më sysh...

Delira hutohej kur vinte re përkujdesjet e pleqve për
të. Kishte diçka të pazakontë në sjelljet e tyre. Diç-
ka që ajo nuk e kishte gjetur as te prindërit e vet. Në
kujdesin e tyre fshihej një farë drojtjeje një lloj frike e
pakuptueshme. Me kalimin e kohës ajo ndjeu se në the-
llësi të syve të plakut fshihej një qortim. Shpesh asaj i
bëhej se plaku matej të thoshte diçka, kishte një dëshirë,
diç e mundonte dhe, për herë të parë, kur e pa t'i binte
të fikët, vuri kujën. Ajo nuk e dinte që Palit prej shumë
vitesh i ndodhë kështu. Trupin e kishte të drejtë, po
zemrën të dobët.

— Ç'ke, babë? — e pyeti, kur Pali erdhi në vete.

Ai fshiu djersën nga balli dhe, pasi u mendua një
çast, u përgjigj, pa e parë Delirën.

— Nesër... do të shohësh...

Delira mbeti e habitur. Mos ndoshta kishte pësuar
ndonjë tronditje në tru?

Të nesërmen, pa dalë dielli, Pali shkoi në mal dhe u kthye me një trup pishe, ngarkuar mbi kalë. Qysh atë ditë e preu në dhoga, i la të thaheshin dhe, pas ca kohësh, zuri të punonte mbi të.

— Ç'bën kështu? — e pyeti e shoqja.

— Djep! — u përgjigj me zë të thatë, të prerë e me një ton të tillë, që ta dëgjonte edhe Delira, që atë kohë po fuste lopën në ahur.

Dhe Pali, pasi e mbaroi djepin, filloi të gdhendte me biçak lloj-lloj lulesh e rabeckash, për orë të tëra. Në fytyrën e zymtë i binte një drithë e butë, dhe ngjante se lodhja nuk e mundonte, po i jepte kënaqësi.

— Përse lodhesh kaq shumë, babë? — i tha Delira një ditë.

— Njeriu lodhet duke pritur, bijë. Ti nuk e di sa vitem kam që pres e pres.

— Çfarë pret, baba?!

Pali e mbylli biçakun, e futi në këllëf dhe, duke parë tutje, drejt arave të mbjella me misër, u përgjigj:

— Fëmijë pres!

— Fëmijë?! — përsëriti krejt e habitur Delira dhe në çast u bë flakë e kuqe në fytyrë.

— Fëmijë, thashë. Po mbushet viti, kurse ai, kafili, mendjen firifiu.

U duk sikur ato fjalë i tha me lehtësi të madhe, po, në të vërtetë, ato minuta e munduan shumë. U mat të ikte, eci disa hapa, veçse kur ndjeu gjunjët t'i këpupeshin... Kërkoi të mbetej vetëm dhe, siç ishte, dyllë i verdhë, qëndroi një copë herë të gjatë i menduar.

Pas kësaj, djepin nuk e preku më me dorë, kurse nusen nuk e shikonte në sy. Si me Dinin, si me Delirën filloi të sillej ftohtë. Kjo kthesë e befasishme i shqetësoi të rinjtë, aq sa një mbrëmje Dini u përpoq të sqarohej,

duke e nisur bisedën larg e larg e urtë e butë. Po plaku ia preu shkurt:

— Dëgjo këtu! Nuk të kam thënë gjë që fute në shtëpi tryezë, lugë e krevat... se njerëz jemi dhe si njerëz duam të jetojmë. Por shtëpinë nuk e mbushin trarët e plaçkat, po njerëzit... Mjaft! — Dhe bëri një lëvizje të prerë, se ndjeu një të therur në zemër. Nuk kam gjë, — i tha Dinit, kur ky i shkoi me ngut. — Më lër të qetë.

— Po unë doja...

— Mjaft! — ia preu përsëri fjalën Pali, që s'përmabahej, kur biseda sillej rrëth fëmijës.

Dhe qysh nga ajo ditë u bë grindavec, asgjë nuk i pëlqente.

Një mbrëmje, në shkurt, ndërsa jashtë frynte erë e ftohtë, Pali qe kërrusur mbi oxhak dhe po mundohej të ndizte zjarrin, kur dëgjoi që dikush u kollit sipër tij. Ktheu kokën i ngrysur dhe pa të shoqen që buzëqueshte, pa i thënë asgjë. Në fillim sjellja e Maries e habit, po kjo nuk zgjati veçse disa sekonda, se menjëherë i hipi gjaku në kokë.

— Ç'ke? Lojte nga mendtë? Ç'më zbardh dhëmbët?

— Ngadalë, ngadalë, se i tunde muret nga vendi!

Pali mbeti me gojë hapur. Po kjo pikë e zezë! Ç'po bënte vaki kështu? Mos erdhi puna deri aty sa të talle-shin me të?! Plaka vazhdonte të buzëqueshte me quesëndi.

— Plakë!... Ç'pate, të rrodhën trutë? Hë, de, fol!

— Ugur i mirë, plak, — i tha ajo dhe bëri një lëvijë tje të çuditshme me dorë.

— Ç'thua, moj?

— Ajo... — dhe përsëri bëri gjysmë harku me dorë, sipër barkut.

Plakut iu shkryth fytyra dhe zuri të queshte në një mënyrë të tillë, sikur kollitej, sikur e zuri lemza.

— Më së fundi... më së fundi...

U çua dhe zbriti poshtë, në bodrum...

1

Akoma vazhdonte të ndiente të njëjtin shqetësim. I dukej se në fund të barkut i peshonte një lëmsh i butë, si të ishte një ushqim i patretur, që i grumbullohej dita-ditës më shumë. Pak më parë i shkrepi të pinte ujë të freskët nga pusi. Në fillim ky qe vetëm një ngacmim i turbullt, po dalngadalë iu ndez një etje e madhe, që e çoi hovshëm nga vendi, drejt e te pusi. Lëshoi kovën me ngut dhe, sapo ndjeu që takoi në ujë, e ngjiti me rrëmbim dhe e vuri buzë gurëve. Afroi kokën dhe, për disa sekonda, pa me ngulm reflektimin e ftyrës së vet mbi sipërfaqen e ujit. Pastaj piu mirë e mirë, po gjatë gjithë kësaj kohe nuk iu nda nga sytë ftyra e vet. Fshiu me mëngë buzët dhe u përkul mbi pus. «A a a a !» thirri. Nga thellësia u ngrit një jehonë e mbytur. «Dini, Deliraaa!» thirri përsëri, «Dini... aaaa!» u përgjigj jehona. Të dy emrat u shkrinë njëri me tjetrin dhe kjo i pëlqeu. U zgjat sërish mbi grykë të thërriste. Poshtë, aty ku shkëlqente një njollë mavi, ishte sipërfaqja e ujit. Andej vinte një puhizë e lehtë. Delirës iu rrënqeth mishtë; ajo kishte zgjatur gjysmën e trupit mbi grykë. Po sikur... U tërhoq me rrëmbim. Ç'ishin ato mendime të marra që i silleshin në kokë?

U ul pastaj në shkallët e drunjta, aty ku binin rrezet e diellit. Ishte mëngjes i ngohtë e i kthjellët shtatori. Ajo donte të pushonte. Përpara saj shtrihej ara me misër. Nga gjelbërimi i thellë çoheshin hera-herës tufa zo-

gjsh. Tutje, pas murit të gjatë prej guri, hapej një djerri në e pjerrët. Në fund të saj fillonin vreshtat, të ndara prej mure guri të vjetra. Që andej vinin zërat e fshatarëve që vilnin rrushin.

— Të kanë mbetur dhe shumë për të vjelë?

— Pjergullat te lisat.

— Pse qahesh? Rrush si ky i sivjetmi s'ka bërë kurrë vreshti yt.

— Do ta ziesh raki?

— Yshshsh, të përlaftë flama...

Dikush thërriste, dikush qeshte. «Vreshti im», «vreshti yt», kaq kuintalë rrush, kaq raki, kaq pekmez...

Delira mbylli sytë dhe në çast përfytyroi ujin në fund të pusit. Sigurisht, sikur njeriu të bjerë në fund, gjëja e parë që do të shohë, do të jetë fytyra e vet e tmerruar, reflektuar në sipërfaqen e ujit...

U çua në këmbë. Nuk mund të rrinte kot, pa bërë asnjë punë. Vërtet ishte në muajin e nëntë, dhe Maria nuk e lejonte të prekte gjë me dorë, po kjo dremitje e lodhë shumë. E keqja më e madhe qe se nganjëherë i hipnin në kokë disa mendime të çuditshme, që e tronditnin së tepërm. Kështu, disa ditë më parë, siç ishte mbështetur në parvazin e dritäres, tek shikonte tutje lumen malin e zhveshur, që binte poshtë si një pllakë e lëmuar, ajo u drodh fort. Atë çast Dini po provonte të mbathte një palë këpucë të reja. Ai qe kthyer nga Delira dhe e kishte pyetur:

— Ç'ke?

Ajo kafshoi buzën.

— Kam frikë, — u përgjigj.

— Pse ke frikë?

— Mendoj gjëra të këqija...

Dini e pa një copë herë i habitur.

— Pse mendon gjëra tē këqija?

— Nuk e di. Mbase... ngaqë jam... shtatzënë... —

Delira vuri re se Dini shikonte i habitur. — Kështu u ndodh, thonë, edhe grave tē tjera, —shtoi ajo që ta qetësonte.

Dini tundi kokën.

— Po sikur... tē tē çonim...

— Në qytet? — shtoi Delira. — Nuk do baba. Edhe kur i tha nëna tē thërritnin maminë, ai u zemërua. A e di, Dini, unë kam një shoqe mami. Kemi mbaruar bashkë filloren, pastaj ajo e vazhdoi shkollën...

Pas derës u dëgjua e kolitura e Palit. Ai, duke u përkulur që tē mos vriste kokën te dera, u fut në dhomë. I pa tē dy, njëherë Dinin, pastaj Delirën dhe tha:

— Bie shi... Ç'më rri kaq hollë ti, nuse? Hidhe setrën krahëve!

— E kam siklet, — tha Delira, ndërsa hidhte krahëve xhaketën e Dinit.

— Posi, léri nazet... Dhe ti, — iu drejtua Dinit, — ec pak poshtë tē ndreqim bodrumin. Diku pikon...

Kur po zbritnin shkallëve, Delira dëgjoi Dinin që diç i tha tē atit. Ai u zemërua dhe u përgjigj me zë tē fortë:

— Ti thua: *hajde, baba, tē tē tregoj arat e malit. Mjaft!*

«Duhet tē merrem me një punë, — tha Delira, ndërsa hipte nëpër shkallët, duke rënduar, herë në këmbën e majtë dhe herë në tē djathën. Meqenëse i dukej se trupi i shkonte pakëz mbrapa, mbahej mbas murit. Hyri në dhomë, mori ca ndërresa, sapunin e u nis drejt burimit. Të lante tē paktën këto plaçkurina. Burimi ishte pranë një ftoi tē vjetër, që bënte ca kokrra tē mëdha, dyllë tē verdha, tërë lëng. Rreth e rrëth përhapej aroma

e ëmbël e ftoit. Delira filloi të lante. Tek shkumëzonte, ndjeu në fund të barkut shqetësimin e zakonshëm, po punën nuk e la, se mendoi që vetëm kështu do të mund ta harronte këtë ngacmim të vazhdueshëm. Nga duart me shkumë shkëputeshin flluska gjithë ngjyra. Delira nuk donte t'i shikonte këta toptha që plasnin para syve. Ngjyrat e tyre ia merrnin sytë. Përpara ndehej një perde e hollë me ngjyrat e ylberit, që dridhej pa pushim. Ndjeu t'i trasheshin tëmthat e t'i rëndonte koka. Drejtoi trupin, fshiu me llërë sytë, dhe përsëri i rëndoi lëmshi i butë në fund të barkut. U mbështet pas trungut dhe vështrimin e nguli mbi një kokërr ftua që zverdhonte nën rrezet e diellit. Gjeti një shkop dhe u zgjat ta godiste, po nuk e arriti. U përpoq disa herë dhe, kur pa që nuk po ia dilte në krye, u mbështet pas trungut e dëshpëruar. Ndiente dhembje në kyçet e duarve, i thernin gjujët, po dëshira për të kafshuar atë kokërr ftua po e turturonte. Si të bënte? Kokrra e bukur, e mbuluar përgjysmë nga një gjethe, dukej sikur ia bënte me sy dhe buzëqeshte atje lart. Delira filloi ta qëllonte me gurë, por pati një të therur në mes. Vuri dorën në bel dhe u ul mbi një gur.

Atë çast qëndroi pranë saj Dini.

— Moj, je në vete ti?

Ajo pa fytyrën e Dinit që ishte skuqur. E pyeti me zë të qetë:

— Ç'ke ti?

— Si, moj, ç'kam unë? Apo... — Dhe, si gjithnjë, nuk e çoi deri në fund mendimin.

— Kam një dhembje këtu... — i tha ajo, megjithëse nuk donte të ankohej.

— Ke një dhembje... dhe ...

— Dini! — i thirri.

Ajo deshi t'i thoshte se, po të rrinte pa punë, e mbytnin mendimet, po Dini atëherë do të pyeste se çfarë mendimesh ishin këto dhe pikërisht këtë bisedë nuk dinte ta zhvillonte me të. Ai, që në fjalët e para, e shikonte me një habi të madhe. Me habi dhe me drojtje.

— Dini! — i tha ajo me zë tëëmbël, — dua atë korrën e ftoit.

— Po ai nuk është pjekur akoma.

— S'ka gjë.

— Nuk do arra të njoma dhe rrush?

— Jo, dua ftohin.

— Ftoin, ftoin... mirë ahere, bëj si të thotë koka, — i tha ai me të qeshur dhe e rrëzoi ftoin me një shkop.

— Na, haje gurin. A mund ta hash dot gurin?

— E ha, — tha ajo dhe e mori ftoin, i fshiu mirë e mirë pushin dhe, duke buzëqeshur, me vështrimin tinar, ngulur te Dini, e kafshoi. Lëngu i mbushi gojën. Ajo e përtypi, po nuk mundi ta kapërdinte. Mishi i ftoit ishte i fortë, si një copë shollë. Delira pështyu dhe qeshi.

— Eh, të thashë.

— Po unë do ta ha, sikur qeni qepë të hajë...

Dhe e përplasi ftoin në gur. Pastaj zuri ta kafshonte e ta përtyponte me ngut. Po përsëri nuk e çoi deri në fund.

— Dreqi! — tha dhe e hodhi tej. — Ç'ke që më shikon kështu?

Dini befas pati dëshirë t'ia pushtonte kokën midis duarve dhe t'i thoshte që e donte shumë, shumë. Kush edi për ç'arsye u mbush gjithë gëzim.

— Delira! — i thiri ai, pa ditur si të shprehte gëzimin dhe i vuri dorën në kokë.

Ajo buzëqeshi dhe fytyra ngjyrë trëndafili iu bë kaq e bukur, sa Dini nuk u përmbajt, por e zuri me të dyja duart pér qafe.

— Ç'bën kështu?! — i tha ajo, po tërë qenia e saj shprehte të njëjtën dëshirë me të Dinit. — Po sikur të na shohin?... — shtoi pas një çasti dhe e vari kokën anash, si një lule. Pastaj u afrua më pranë tij.

— Le të na shohin, — thuajse thirri ai. — Pse trembemi kështu ne?

— Eshtë mesi i ditës... nuk jemi në shtëpi... mund të na shohin dhe është turp... — thoshte Delira duke u përkëdhelur, me kokën mbështetur te supi i Dinit. — Nganjëherë kam kaq mall, sa nuk dua të largohem një orë prej teje... Po ti?

Papritur asaj i rodhën lotët. Ca lotë të mëdhenj, të ngrohtë...

Pas kaq kohësh ai po e përkëdhelte përsëri. Dhe ku, ja këtu, midis fshatit, në mes të ditës. Nëpër trup i kalonin ca rrëqethje të ëmbla. Pra, nuk qenka e vërtetë që dashuria digjet e digjet si një copë dru, derisa mbetet hiri.

— Pse qan? — e pyeti i habitur.

Nganjëherë i dukej se nuk e njihte aspak Delirën. Ajo kishte diçka të fshehtë, ishte e pakuptueshme dhe e pakapshme prej tij.

— Delira, — foli ai me një zë të ngrohtë, — më dëgjon? Hë, kështu... Mos trembesh nga lindja? Jo?... Po ç'ke ahene?...

— Të dua shumë, — i tha ajo.

«Çudi! Mbështetur... kushedi... nuk i kuftoj këto gjëra...», mendoi ai.

— A e di se sot do të vijnë të jatin shfaqje artistë nga Tirana? — i tha Dini që ta gëzonte.

— Ashtu?! Sa qejf kam që t'i shohim!

«Kurse qëparë qânte», mendoi përsëri, pa e kuptuar që në ato çaste ajo po provonte një lumturi të madhe.

— Po ne s'besoj të shkojmë, — i tha ai.

— Pse, Dini?

— Sonte kemi dajën për darkë, e ka ftuar baba për punën e shtëpisë. Unë po zbres poshtë të blej ca harxhe. Do të shes edhe dy kofina me rrush. Ç'ke qejf të sjell nga qyteti?

— Kthehu shpejt! — i tha ajo dhe pa Dinin me hejbet hedhur subit, që gjithë gëzim e gjallëri, mori udhën e ngushtë, shtruar me pllaka, që kalonte anës arave, rrethuar me mure gurësh. Dhe e pati zili Dinin...

Njëherë ajo pat qenë në Tiranë. Ishte mbrëmja e 1 Majit. Shëtitnin në bashku me Dinin. Sheshi ishte mbushur me aq shumë njerëz, sa mezi lëvizje. Njerëzit qeshnin, pëshpëritnin kushedi çfarë gjérash të bukura, sytë u shkëlqenin, kurse fytyrat u dukeshin aq të përzemërtë, sikur i njihje prej kohësh. Zemra e Delirës rrihte me forcë. Ajo ecte si nëpër èndërr... Pastaj në podium u ngjitën artistët. Nga altoparlantet fluturoi kënga... Pas pak, papritur, sikur gjëmoi toka, dhe qielli u mbush me lule ngjyra-ngjyra. Çfarë mrekullie! Qielli u shndërrua në kopsht lulesh. Nëpër tërë hapësirën ngjante se gurgullonte një gëzim i madh... i madh...

Delira rënroi nga dhembja. Mbuloj sytë me dorë dhe ca çaste mbeti e mbështetur me kurriz pas trungut të ftoit. Edhe me sy të myllur, i bëhej sikur shikonte një dritë të bardhë, të fortë, që ndehej para saj. Dhembja iu përhap nëpër tërë trupin. E ndjeu veten të dërrmuar e me mundim të madh u ul.

Maria, që po sitte miellin, e kishte parë Delirën kur po zbriste drejt burimit. Ajo u merakos që nuk po kthe-

hej dhe shkoi të shikonte. E gjeti të ulur mbi gur, me kokën zënë midis duarve. Këmishët e qullura gjithë sapun i kishte lënë te këmbët.

Maria u zbeh.

— Delira, — i foli dhe u ul në gjunjë pranë saj. — Ç'ke?

Delira u mundua të buzëqeshte.

— Më duket se po...

Maria zgjati dorën dhe ia rregulloi flokët që i kishin dalë nga shamia dhe i qenë shpërndarë nëpër faqe. E përkëdheli.

— Shkojmë? — e pyeti.

Delira nuk foli. Rënkoj.

«E kanë zënë të prerat», tha me vete Maria dhe i largoi përsëri flokët nga sytë. Mbi ballë dhe rrëth syve kishte bulëza djerse. Maria ia fshiu me bishtin e shamsë. Një çast Delira e pa me një vështrim të humbur.

— Delira!... Zemër, përmendu... Mos ki frikë, zemër, mos ki frikë...

Delira buzëqeshi.

— Jam e gjuar, nënë... veçse kam dhembje. — Dhe vuri kokën te prehri i Maries.

Ajo u mundua ta ngrinte, por, kur ndjeu gjithë atë peshë te krahët, u tremb mos rrëzohej. Duke e mbajtur me kujdes për supesh, e ngriti në këmbë dhe bashkë me të u mbështet te trungu i ftoit.

— Hajde, ecim, nënë, — tha Delira.

Maria dëgjoi se si Delira merrte frymë me mundim.

— Mirë, zemër, mirë, ja të thërrasim edhe Palin.

— A dëgjove, oreec! — thirri ajo. — Hoheej!

Pali doli në oborr.

— Hajde, more, luuaji!

Pali lëshoi zërin si bubullimë:

— Pse thërret kështu, kur je tc hija e shtëpisë?...
Gjarpri të kafshoi...

— Zbrit shpejt, se Delirën...

S'arriti të dëgjonte fjalët e fundit, se u lëshua me vrap drejt burimit dhe, sa po pa Marien që mbante me mundim e frikë Delirën, mbeti edhe ky i ngrirë.

E? — pyeti me një zë krejt të pasigurtë dhe priti me ankth përgjigjen.

— Ç'u hutove kështu? E kanë zënë të prerat... Ec mbaje, se po më shpëton nga duart...

Pali menjëherë u çlirua nga tensioni. «E kanë zënë të prerat», përsëriti me mend, dhe të gjitha fjalët patën një tingëllim që zotëroi gjithçka. Dhc buqëzeshi. Pra, ja ku erdhi më në fund dita...

— Lëshoma! — i tha. I mori krahun Delirës dhe e hodhi në qafën e tij.

— Ki kujdes, burrëziu, se...

— Ec ti, ec, shko përpara...

«O zot, shyqyr, më në fund... Nuk mund të vdiste Pali pa dëgjuar zërin e fëmijës në shtëpinë e tij... Mos u tremb, kotele, pse dridhesh?... A e kam shtruar dy-shekun në bodrum?» Mendimi i fundit që i vetëtiu befas në kokë, qe kaq i fortë, sa ai, pa u kujtar kë mbante në krah, e shpejtoi hapin. Delira u trondit.

— Qetësohu, bijë, qetësohu! Jam plak matuf... më kanë rrjedhur... Harrova se... unë nxitova...

Delira nuk foli.

Pali dëgjoi rënkimin e saj dhe u habit sa shumë po e përbante veten ajo. I ngjiti shkallët dhe hyri bashkë me të në dhomën e madhe të zjarrit.

— Këtu! — i tha e shoqja dhe i tregoi me gisht dy-shekun, shtruar afër oxhakut, ku kishte vënë të digjeshin drutë.

Pali e lëshoi me kujdes.

— Mos e ka kokën ulët? — pyeti ai, duke parë me dashuri drejt së resë që kishte humbur në gjumë.

— Lëre, mos e trazo... Ja, t'i hedh edhe jorganin... Shpirti i nënës, sa është zverdhur!

Të dy pleqtë qëndronin në këmbë dhe e shikonin me gëzim, me drojtje e dhembshuri Delirën. Tani në fytyrën e saj kishte rënë një nur i lehtë dhe mbi buzët e saj të fryra, gjysmë të hapura, notonte një e qeshur fare-fare e lehtë.


Papritur Delira lëshoi një rënkim të thellë. Pleqtë u drodhën dhe u kapën dorë për dore. Hija e lumturisë u fashit menjëherë. Në tiparet e saj u reflektua shqetësimi. Gjatë gjithë kohës që e prisin dhembjet, ajo, siç ishte e përhumbur, papushim mendjen e kishte te Dini. Brenda atyre minutave ajo e pa me qindra herë Dinin, në situatat më të ndryshme, dhe kjo reflektonej në fytyrën e saj.

— Të thërrasim maminë! — tha Maria, ndërsa shikonte e shqetësuar Delirën, që ishte përmendur e përpinqej të buzëqeshte.

— È? — pyeti Pali dhe, sikur të mos kishte dëgjuar mirë, pyeti përsëri: — Si the?

Edhe Pali e mbledhi veten. Deri tani kishte qenë i lumtur dhe kishte vepruar si nëpër èndërr, si i shushatur. Vetëm një herë rrugës i kishte vetëtirë një mendim i kthjellët, po ai qe avulluar shumë shpejt dhe nuk i kishte mbetur gjë tjetër, veçse ndjenja e dhembjes, e gëzimit, e drojtjes.

«E humba pusullën», — tha me vete. — Kështu dehen njerezit dhe e humbin burrërinë. Pal! Mblidhe dynjalëkun. Ti nuk jë grua. Ti je kreu i shtëpisë dhe i di zakonet.»



— Çfarë the, moj? Mbylle!... Ti e di mirë se ç'duhet të bëjmë. Pse më rri e më nusëron?... Ku është dysheku? — Dhe e pa të shoqen gjithë zemërim, sikur deshi të gjente shkakun e dobësisë së saj. Shkoi e hapi musandrën dhe e bëri lesh e li, pa gjetur gjë.

— Moj, ku e ke fshehur... djallin!

Maria ia lëshoi para këmbëve.

— Kurrë nuk ke qenë i zoti për këto punë. Dhe mos bërtit, se ia trembe gjakun...

Ai e hodhi dyshekun mbi sup dhe zbriti shkallët me nxitim.

— Ku e çoi babai dyshekun? — pyeti Delira me gjysmë zë.

— Poshtë, bijë... në bodrum.

Në fytyrën e Delirës ra një hije.

— Pse e zbriti në bodrum? — Zëri i saj tingëlloi i thatë.

Maria i mori dorën.

— Ti, thëllëzë e nënës... Është mirë, kështu e do zakoni... që mos të të marrin më sysht...

Delira i rrudhi vetullat e gjata e të holla.

— Nënë!

— Mos u tremb, bijë! Pse trembesh? Do ta shohësh se nuk ka asgjë të frikshme... Pali e ka rregulluar prej kohësh shtratin e drunjë. Tani do të shtrojë dyshekun...

— Do të më zbritni poshtë? — pyeti Delira, dhe sytë e saj e shikuani Marien ftohtë.

Ajo ia mori dorën dhe ia përkëdheli.

— Unë nuk dua të zbres.

— Gjithçka do të kalojë fare lehtë. Ke për të parë... Ne... ja, këtu jemi... Unë do të jem gjithmonë pranë teje.

— Jo, nënë, unë nuk do të zbres...

Maria e dinte që, më shumë se për çdo gjë, Delira kishte nevojë për qetësi. Por ajo kuptonte, gjithashtu, se më parë duhej të qetësohej vetë dhe përpiquej me të gjitha forcat ta zotëronte veten, të fliste me një zë sa më të shtruar. Po zëri i dridhej, dhe nga sytë e Delirës e kuptonte që në fytyrën e vet kishte pasiguri dhe keqardhje.

— Nuk do të zbres, — përsëriti nusja dhe ia shtrëngoi gishtërinjtë e rrudhur plakës. — Më ndihmo, nënë!

— Mos u shqetëso, zemër... Kjo do të ndodhë... Thuaj shyqyr që erdhi sahati e qoftë i hajrit... Disa orë janë... shumë-shumë një natë... Ç'të duhen ty njerëzit përreth... Kur lind, është më mirë të jesh vetëm. Fare vetëm... veç njeriut që do të kujdeset për ty...

Befas plakës i shkrepri një mendim i çuditshëm: «A s'është më mirë që nusja të mbetet vetëm, këtu lart, dhe ne të zbritnim poshtë? Ajo u përpoq shumë ta largonte këtë mendim dhe pandehu se e largoi.

— Nuk dua të zbres në bodrum, — përsëriti Delira me zë më të butë.

Tanimë ajo nuk ndiente dhembje. Hera-herës i shkonte ndonjë e prerë, dridhej, po dhembje të vazhduese shme nuk kishte. Kishte vetëm frikë.

— Kur lind, është mirë të jesh vetëm, se, po e morën vesh graria, — vazhdoi të fliste plaka, — vijnë e gumëzhijnë si koshere mbi kokë. Pak më parë më pyetën për ty... po unë i gënjeva e u thashë se je mirë... se akoma nuk të kanë zënë të prerat... Për kokën e Dinit, nuk durohen, po të vijnë këtu... Le që, ku ta dish, ndonjëra prej tyre mund të ketë edhe sy të lig... Kupton, qumështorja e nënës... Pastaj, gruaja, kur lind, është mirë të mendojë gjërat më të bukura që ka parë në jetën e vet...

— Pse? — e pyeti e habitur Delira.

— Thonë se kështu fëmija lind i bukur dhe i fortë... Këtë e kam dëgjuar nga një grua që kishte ardhur prej Misiri...

Maria heshti një copë herë dhe e pa me vëmendje të renë që po qetësohej gjithnjë e më shumë. A thua harrroi që pas pak do të zbriste në bodrum? Apo kjo gjë tanimë nuk e trempte? Apo ndoshta shpresonte që njerëzit e kishin zbuluar tmerrin që e kishte pushtuar dhe nga keqardhja kishin hequr dorë nga ky mendim?... Ndryshe, përse nënë Maria dukej tani e qetë dhe i fliste me zë kaq të ngrohtë? Mos kishte parë ëndërr? Si do ta linte ajo të zbriste në atë errësirë, në atë vetmi, kur atë e mbyste ankthi edhe midis njerëzve?...

Delira buzëqeshi dhe priti me padurim vazhdimin e tregimit. «Shpirt i nënës, shpirti i nënës!», pëshpëriti me vete Maria dhe për një çast, kushedi pse, i erdhi t'ia plaste të qarit. U gëlltit dhe heshti.

— Po pastaj? — e pyeti Delira.

— Çfarë? — mbeti e turbulluar plaka.

— C'të tha ajo gruaja nga Misiri?

— Ah! Zonja Merihan... Është histori e vjetër... Ata rrinin në qytet. Zonja Merihan me të shoqin kishin një dyqan dhe shitnin plaçkurina të ndryshme. Po verës vinin të pushonin në fshatin tonë, se zonja Merihan vuante nga azma dhe ajri i malit i bënte mirë. I shoqi kishte dajallarët në fshat... Hajde, more, hajde, sa çuditeshim kur i shikonim të vinin! Në të hyrë të fshatit zbritnin nga kuajt, kapeshin allabracë, hapnin një çadër tërë lulka, që të mos i vriste dielli dhe ecnin nëpër rrugën me gurë. Ne i shikonim dhe mekeshim së qeshuri...

Nënë Maria zuri të queshte dhe bashkë me të e vuri buzën në gaz edhe Delira.

— Oh!... Oh!... Lëre c'vente... Apo nuk më

mbante levendi një kapele të madhe prej kashte... Pa lë kur na doli në mes të zhegut, një ditë, na vuri një stol në mes të diellit dhe, i zhveshur lakuriq, vetëm me të mbathura, i ktheu shpinën diellit... Neve, grave, gati sa nuk na ra pika nga turpi dhe vdiqëm së qeshuri. Kurse burrat u tërbuan nga inati. «Ç'është ky cipëplasur kështu! Mor, po e di ky ku ka ardhur, apo i kanë rrjedhur? De, lanet, që na fut në mëkat...».

Dhe kështu, me radhë, flitnin burrat e do ta kishin bërë për ujë të ftohtë sikur të mos i kishin çuar fjalë në vesh që të hiqte dorë nga yrneckët e mësuara matanë dieillit...

Maria heshti përsëri dhe, për disa çaste, u duk se po mbante vesh të kapte zhurmën që vinte nga jashtë. Iu bë se nëpër shkallë po ngjitej Pali dhe kjo i kujtoi gjëzimin që i kishte pushtuar të dyja: vjehrrë e nuse. Si shpjegohet që nganjëherë, në pritje të minutave të tillë të pushtohesh nga një gaz i shfrenuar?... Jo, zhurma nuk vinte nga shkallët. Vinte nga poshtë. Si duket Pali ndreqte diçka... Pse u vonua?

— Po pastaj, si vazhdon historia? — ngulmoi Delira, që e kishte harruar realitetin.

— Eh, moj bijë, këto janë histori që kanë ndodhur 40 vjet të shkuar. Ahere edhe unë isha e re... Nejse... Po... ku e lamë llafin?

— Te zonja Merihan... Si qe puna që të tha se gruaja duhet të mendojë gjëra të bukura...

— Po... po... ahtere unë isha shtatzënë. Zonja Merihan, që i vinte ndoresh puna e mamilë, erdhi e më pa dhe më tha që të qëndroja me sy të mbyllur e të kujtoja për orë të tëra gjërat më të bukura të jetës sime. Bëj kështu, më tha, se do të lindësh një fëmijë të bukur si dielli dhe trim si luani...

— Po ti, bëre si të tha?

— Ashtu bëra...

Maries iu kujtua dritarja e vogël nga hynin rrezet e pjerrëta të hënës, ftyra e gjatë e Merihanit dhe sytë e saj të mëdhenj. Nga jashtë vinte zëri i Palit. Gjithçka akoma shkonte për bukuri dhe ajo ishte e lumtur...

— A mund të më thuash, ç'kujoje kur rrije me sy mbyllur?

Maria u përmend dhe qeshi përsëri.

— Posi, ja... Një muaj më parë unë pata shkuar me Palin në Tiranë të vizitohesha te një mjek i mirë, se më qe mahisur e më pat mbledhur gjiri. Mbaq mend se hipëm në një autobus të kuq. Kjo ishte hera e parë që hipja në autobus. Pasdite u ulëm në një lulishte, në karrige prej kashte. Rreth nesh kishte burra me mustaqe të holla dhe me borsalina, që rrinin këmbë mbi këmbë dhe as nuk pinin e as nuk shtinin gjë në gojë. Po habia më e madhe qe kur Pali zgjidhi shaminë e më dha të haja një ëmbëlsirë me shkumë të ngrirë. Veç të shikoje si i hapën sytë zotërinjtë! Pastaj, pa e ndier, dikush erdhi pas kurrizit, u përkul mbi ne dhe na pyeti me zë të ulët: «Nuk mbani ramazan?» Pali iu përgjigj se ishim të krishterë. «Keni gjë për të shitur, drith, kafshë, lëkura...» Pali i tha se kishin ardhur për hall. Dhe ai përsëri deshi të dinte gjithçka... Kur u largua burri me gjyslykë, e pyeta Palin se ç'donte ai prej nesh. Më tha se kishte të tillë në Tiranë, që i kishin gishtërinjtë të lyer me zamkë dhe përpinqeshin t'i ngjitnin te napolonat e shkreta të fshatarit... Maria pushoi së foluri se pa që Delirën e kishte zënë gjumi.

«Kështu si po hap unë këtë derë, — tha me vete Pali, ndërsa vërtiste çelësin në bravë, — u hapshin portat e fatit të fëmijës.»

Bodrumi ishte i errët dhe gjithë lagështirë. Pali eci nëpër errësirë, gjeti qiririn që e kishte lënë në vrimën e hapur në mur, e ndezi dhe e vuri përmbi kokën e shtratit, sipër një guri. Flaka e qiririt ndriçonte zbehtë një pjesë të kësaj kthine të ngushtë e të gjatë, pa tavan, pa dritare, veç derës që rrinte zakonisht e mbyllur. Denbabaden këtu grumbullonin plehun, kashtën, gjethet e du-shkut e rrangulla të tjera. Prej vitesh ajri këtu ishte rënduar aq tepër, sa dukej sikur vishte edhe muret e trasha prej guri me një lloj afshi mbytës. Pali kishte rreth njëzet ditë që nuk kishte hyrë këtu, nga koha kur pat rregulluar shtratin e drunjët dhe pat pastruar plehun e tërë rrangullat. Atëherë, disa orë, natën, ulej në një stol, e linte derën hapur dhe ruante mos futej njeri brenda. Bodrumi duhej ajrosur se edhe vetë, megjithëse i rritur midis avullit të bagëtive e të plehut, ai nuk e duronte dot afshin e rëndë që qëndronte pezull. Po bodrumi nuk pastrohej nga kutërbimi. Prej vitesh e vitesh lëngu i plehut të bagëtive e i gjetheve të kalbura kishte depërtuar thellë në tokë dhe erën e rëndë të tij nuk ishte e mundur ta shqitje prej andej. Dhe lagështira ngjitej mureve të gurta. Pali rrëmoi dheun me lopatë, ndonjë pëllëmbë, dhe e hodhi në përrua. Dhe iu duk se vërtet, në bodrum ishte futur një puhizë... Plakut nuk i shkonte ndër mend se, duke qëndruar gjatë në bodrum, që mësuar edhe me kutërbimin, edhe me errësirën, edhe me lagështirën. Por tani, kur hyri përsëri, pas njëzet ditësh, afshi i rëndë që ngrihej nga toka dhe muret tërë igrasi, i zuri hundët.

,

«Bën edhe ftohtë këtu», — tha plaku, ndërsa shtronte dyshekun në shrat. «Që të mos mërdhijë, do t'i hedhim edhe jorganin, edhe gunën».

U ndie i lodhur dhe u shtri mbi dyshek. Sipër kokës, mbi trarët e nxirë nga bloza, vareshin pëlhura të trasha merimangash. Plaku mbylli sytë dhe e ndjeu veten të zhytur në vetmi. Lagështira i depërttoi nëpër rroba dhe i hyri gjer në mish. U rrëqeth. «Do ta ketë zor, e shkreta!» Befas e mundoi një mendim i turbullt, i papërcaktuar mirë, që i qe ngjallur para disa muajsh: i dukej se po bënte diçka që nuk i pëlqente ta bënte. Ai nuk kishte dëshirë ta kthjellonte këtë dyshim, se menjëherë, po në këtë çast, i dukej se po hynte në mëkat.

«Ne na tremb errësira, — mendoi plaku, — po gruaja që sjell njeriun në botë, duhet të rrijë në errësirë... Nga errësira lind drita...»

Plaku u çua ndenjur dhe u mundua të kujtohej kush ia kishte thënë këtë mendim. «Kështu është thënë nga perëndia, që gruaja të lindë... Ajo edhe do të vuajë dhembjet e gjithë heqjet... Thonë se, sikur burri të dijë dhembjet e gruas që lind, dhe fëmija ta ndiejë sa dashuri ka nëna pér të, gruas nuk do t'i thoshin kurrë një fjalë të rëndë... Përse lipset të vuajë errësirën dhe këtë ajër të rëndë?... Ku ta dish, gjithë këto heqje i janë taksur, se ajo mban gjallë dynjanë e shkretë... Kush mban shumë, vuan shumë... Mos vallë, duke lindur fëmijën, gruaja lind edhe mëkatin?»

Plaku u kollit dhe bëri një lëvizje nervoze.

«Ç'janë gjithë këto llafe!... Mirë thonë që plaku lodh veten me fjalë... Më duket sikur po lexoj librin e shenjtë të uratës... Si, xhanëm, më janë ngulur në kokë tërë këto...»

U çua në këmbë dhe, ndërsa shikonte hijet që zgjatosheshin nëpër mur, tha përsëri me zë të ulët:

«Gruaja duhet të lindë në errësirë, që të mos e shohë syri i keq... pra... Pse u çova në këmbë? Ç'kisha ndër mend të bëja? Ku doja të shkoja?» U mundua të përqëndrohej. «Plak matuf... plak matuf... Kush ka shumë llafe, bën pak punë. Hajde, luaj vendit...», i tha vetes dhe doli jashtë.

Drita e butë e vjeshtës e rrëthoi të tërin dhe ai mori fryshtë me gjithë mushkëritë. Ah, sa mirë! Pastaj i mbylli sytë, se rrezet e diellit e verbuan.

«Po shkoj lart të marr gërvshëret», tha, po aty për aty ndërroi mendje, kur kujtoi se do t'i lipsej të hynte në dhomë dhe të shikonte Delirën që rënkonte nën rroba.

«Të mbaroj njëherë e mirë punët që më kanë mbetur nëpër këmbë, pastaj ngjitem lart. Ç'më lipsen gërvshëret... kur kam biçakun?»

Në thellësi të ndërgjegjjes ai donte ta zgjaste sa më shumë çastin kur do të shkonte lart për të zbritur Delirën. Po këtë dëshirë nuk donte ta pranonte dhe i gjente punë vetes.

Në oborr, pranë pusit, qenë mbledhur disa vajza që qeshnin e flitnin me zë të lartë. Pali i pa ato dhe nuk deshi të kalonte pranë tyre, po rrugë tjeter nuk kishte. Kur iu afrua pusit, ato pushuan. Pastaj zunë të pëshpëritnin, dhe Palit iu duk se flitnin për të. Njëra ia plasi gazit me gjithë shpirt.

Pali ktheu kokën dhe vështroi drejt tyre. Vajza e ndërprenë të qeshurit. Ra qetësia.

— Mos ua vër re, — tha njëra prej tyre. — Janë të reja dhe u qesh zemra. — Ajo që foli ishte një grua me fytyrë të gëzuar, që Pali e njihte mirë. Ishte anëtarë e këshillit të fshatit dhe përgjegjëse e gruas.

— Gjithkush bën aq sa di, — tha Pali.

Njëra nga vajzat i ra pa dashje me bërryl kovës, dhe uji u derdh në fustanin e shoqes. Ato ia plasën sërish të qeshurit.

— Veçse edhe gazi ka karar, — tha përsëri Pali.

Vajzat u larguan. Mbeti vetëm përgjegjësja e gruas. Kur Pali u mat të ikte, ajo e pyeti:

— Si është Delira?

— Mirë, — u përgjigj prerë Pali.

— Po të ketë nevojë më thëritni... Desha të vija sot, po më dolën punë. Pasdite do të kemi shfaqje... Ne, gratë, ia dimë njëra-tjetrës hallet... Unë jam gati të vij në çdo orë...

Tutje u dëgjua e qeshura e vajzave.

Pali u pëershëndet me të dhe vazhdoi rrugën.

Kur po ngjitej drejt bregut, ku qe pjekur rrushi më i mirë i vreshtit, rrushi debin, kokërrmadh, dyllë i verdhë dhe iëmbël mjaltë, atë e takuan fshatarët.

— Nga vete kështu, yrysh, o Pal? — e pyeti njëri.

— Lart, — u përgjigj shkurt Pali.

— Nuk do të vish nga sheshi... Kanë ardhur nga Tirana të japid shfaqje. Hajde, more, hajde, ç'do të kërcasë gjadja sot! Të lajmëruan ty?

Pali nuk foli.

— Dil nga darka në këshill të marrësh edhe ti ndonjë artist në shtëpi...

Pali nuk dha përgjigjje.

— Hë, si thua?

Pali e pa tjetrin në një mënyrë të tillë, sikur të kujtohej për diçka.

— Ku e ke llafin, o Mark? — e pyeti Pali.

— Sa nga ata të Tiranës do të marrësh në shtëpi?

— Nuk mundem, — tha Pali, — asnjë...

Shtëpia e tij i kishte pasur gjithmonë dyert të hapura për miqtë. Shtëpi e madhe, thoshin, nuk të turpëron. Kurse tani, papritur, ai i mbylli dyert.

Fshatarët nuk e pyetën më, po e panë njëri-tjetrin me një farë dyshimi. «Si ishte puna me Palin?»...

— Ashtu kam një hall, — tha Pali që të sqarohej, po, me të përmendur fjalën «hall», u pendua dhe u ngut të shtonte se do t'i vinte për darkë i kunati.

Fshatarët nuk folën.

— Kemi një bisedë, ashtu... për ndërtimin e shtëpisë së re... Ti e di, o Mark.

— E di, — tha Marku. — Aq më mirë. Në gostinë e sotme shtroja edhe me këngë. A ke qejf të sjellim një artiste, bukuroshe... — shtoi ai me të qeshur.

«Po vonohem», tha me vete Pali dhe ndjeu që po i vërshonte gjaku.

— Nuk mundem... nuk mundem! — tha me rrëmbim.

— Përse nuk mundesh, ç'hall ke?

«Ky djall gjithnjë dyshon. Rrëmon e rrëmon që të nxjerrë në shesh të vërtetën dhe ka një shikim që të shpon...»

Pa me ngulm fytyrat e fshatarëve dhe mendoi: «Ci li prej këtyre mund ta ketë marrë më sysh Delirën?»

— Si u bë nusja? — e pyeti Marku, pa ia ndarë sytë, sikur përpinqej t'ia lexonte mendimet.

— Nusja është mirë, — tha plaku dhe pa se sytë e Markut, të prerë e gjysmë të mbyllur, sikur buqëzeshnin me qesëndi.

«Ky, — tha me vete, — ky ka sy të lig.»

— Muaji i nëntë do kujdes, — ngulmoi Marku.

— Plakën nuk e kam mirë. Ka një trazirë dhe tha-shë t'i çoj nja dy veshë prej «debinit», — ndërroi bisëdë Pali.

— Akoma nuk e paske vjelë? — pyeti Kola.

— E vola, po kam lënë ca, për ndonjë rast... se nuk i dihet.

— Ashtu është, vëlla, ashtu është... Mirë e ke, — shtoi një fshatar tjetër.

E zjeve rakinë? — pyeti Kola.

— Zjeva ca, sa për t'u gjendur... Mirë jemi, mirë, gjynah të qahemi. Mbajti koha sivjet...

Kola i zgjati kutinë e duhanit.

— Desha të çoja llaf, po ja ku u takuam, dhe unë them që nuk është turp të kërkoja... të bleja ca kile prej asaj rakisë sate...

— Shohim e bëjmë, — e ndërpren Pali.

— Ti e di pse e dua. Pas një muaji do të kem dasmën e djalit. Dhe unë dua ta djeg me atë rakinë tënde, që nuk i gjendet shoqja... Është e dashur pa hesap.

— Mirë, mirë, — tha Pali dhe u bë gati të ndahej. «E zgjata shumë», mendoi.

— Sa për hesapin, të hollat do të t'i jap të thata, në dorë.

— Këtu jemi e merremi vesh...

— Shyqyr, nuk e kam të ftohtë sivjet xhepin. Shita ca kile mollë e dardhë... Nxora edhe unë raki të re, po si ajo jotja nuk gjendet... Ke vresht me nam ti. Që kur ta dha Reforma, thashë: «Lum si Pali!» — tha Kola.

— Po ti, nxore gjë këtë vit? — pyeti Marku.

— Mos qahem... Mirë jam, shyqyr, mirë, — u përgjigj Pali dhe sapo deshi të largohej, kur në çast, si përinat, sërisht e mori fjalën Kola.

— Kur thua të biem në hesap?

— Po këtu jemi, mor Kolë...

— Eh, sikur thashë që do të luajmë vendit. Por mi rrë është...

— Mirë është... mirë është, — u zemërua Pali dhe u skuq i téri në fytyrë. — Ç'e zgjat kështu, sikur ti je në Stamboll dhe unë në Çinemaçin. Në një mëhallë jemi, të shkretën. Tungjatjeta...

— Të vij nesër?

— Jo nesër, — u zemërua përséri Pali. — Ç'është gjithë kjo axhale?

— Po kur të vij, ahore, të shkretën? — pyeti tjetri dhe u mundua të buzëqeshë.

— Eh, po mjaft, dreqi e mori, se ma hëngre shpirtin! Kur e kur e kur... Asnjë pikë raki nuk do të të shes ty, sikur ta di që flori të më japësh për çdo pikëz... Dëgjove, ç'të thashë? Shko tani e bëhu lanet!... Oj, i biri i botës të ngjitet si rrodhe e s'të ndahet... Po ke punëti a, ke halle ti a... nuk do t'ia dijë... Mjaft!

Fshatarët mbetën të shtangur nga ky shpërthim i befasishëm.

— Nuk e dinim se ke hall... — deshi ta qetësonte Marku, po Pali mori zjarr më keq.

— E kush tha që qenkat në hall... Në hall mund të më shtinin, mbasse, vetëm sytë e tu... Ç'ke që ma hap gojën si kamare? Ja ku po ta them unë, që ti ke një sy të lig, që të përvëlon. Edhe kur flet në këshill ti, lëshon ca fjalë që djegin më keq se speci. Shiko punën tënde ti dhe mos i ngacmo urët me mua, se nuk të shkojnë... Nuk kam asnjë hall unë. Kuptove? Ç'më shikon ashtu?... Ke dëgjuar ca llafe grash andej-këndej dhe, o burra, të kemi mendjen se Pali është në hall... Po ç'hall kam unë, a nuk më thua? Hë de, përgjigju, kur e ditke.

— Nuk di gjë, — tha tjetri dhe ngriti supet i hutuar.

— Ahore udha mbarë ju goftë... Mos kini merak për mua...

Dhe, sapo u nda prej tyre me nxitim, fshatarët panë

të çuditur në fillim njëri-tjetrin, pastaj zunë të qeshnin, po me zë të ulët, që të mos i dëgjonte Pali. Njëri prej tyre vuri gishtin në tëmtha dhe e lëvizi në mënyrë të dyshimtë.

— Nuk dihet... nuk dihet, — tha Marku.

— E ç'është njeriu, — shtoi një tjetër, — orë e çast ndërron... Ku ta dish, mund të jetë grindur me plakën apo... Kushedi!...

Ndërkaq Pali kishte zënë të priste me brisk veshët e rrushit. I dridhej dora nga zemërimi dhe herë pas here shante me zë. Pasi e mblođhi rrushin në shami, zbriti nga burimi dhe këputi disa kokrra ftonj, bashkë me degët e gjata. Pastaj u kthyte përsëri në bodrum, hipi mbi një stol dhe i vari veshët e rrushit e kokrrat e ftohit në-për mure.

«Duhej të më kishte rënë ndër mend më përpara. Aroma e ftoit dhe e rrushit do të mbushë tanë bodrumin...». Papritur mbeti i ngrirë majë stolit. «Me ç'këmbë hyra brenda?», pyeti ai befasisht veten dhe u tremb kur u kujtua se kishte hyrë yrysh. «Ç'kam kështu, xhanëm, që jam matufepsur?» Ai donte të dilte jashtë dhe, kur të hynte përsëri brenda, ta shkelte pragun me këmbën e djathtë, po kjo iu duk marrëzi dhe, turbull-turbull, e kuptoi hilenë... «Tani, nuk kam pse të vonohem. Po ngjitem lart», tha dhe sakaq u gjend në krye të shkallëve.

Kur hyri në dhomë, pa se Delira kishte humbur përsëri në gjumë të thellë. Plaka, që rrinte mbi kokën e së resë, i bëri shenjë të ecte me kujdes dhe ai u bind. Hoqi në prag opingat e trasha prej gome dhe, duke shkelur me çorapet e leshta, majë gishtave, kaloi përmes dhomës. Sa herë që kërcitnin dërrasat e dyshemesë, ai qëndronte, pastaj e vendoste me kujdes këmbën, duke u munduar të rëndonte sa më lehtë dhe hidhej tej.

Plaka po e ndiqte me bisht të syrit dhe mezi po e mbante të qeshurit, duke vënë shaminë në gojë. Asaj i bëhej sikur ai po hidhte valle.

Pali arriti deri te qoshja e oxhakut, u ul këmbë-kryq, fare i qetë nxori kutinë e duhanit dhe drodhi cigaren. Pastaj mori një thëngjill dhe e ndezi. Të gjitha lëvizjet tregonin se ishte çliruar nga një tension i fortë, që e kishte munduar deri tanë. Ndiente një kënaqësi të madhe, ndërsa rrinte i zhystur në atë gjendje dremitjeje, pa menduar asgjë. Ishte i kapitur.

— Fle si engjëll, — tha Maria dhe në ftyrën e saj u reflekta dhembshuria. — Hajde ta shikosh! Nuk ngod pem së pari, kaq e bukur është, që ia marrsha të keqen nëna!...

Pali u çua, shkoi nga ana tjetër e dyshekut dhe e pa për një copë herë të madhe. Herë pas here ajo dridhej. Me sa dukej, edhe në gjumë trupi i ndiente dhembjet. Ftyra i qe mbuluar nga djersët. Nga thellësitetë e syve, nëpërmjet qerpikëve të gjatë, përhapej mbi mollëzat e lëmuara, ngjyrë trëndafili, një purpur i lehtë.

«Le të flejë, — tha me vete Pali. — Është gjynah prej zotit ta lëvizësh nëpër gjumë...»

Ai zgjati gishtin e trashë, gjithë nyje dhe me kujdes i fshiu djersën nga tëmthat. Në këtë çast Delira hapi sytë. Megjithëse Pali buzëqeshte, mollëzat e kërcyera, gropëzat e faqeve dhe sytë e mëdhenj gjithë shkëlqim qëndronin të varur si kërcënim mbi të.

— Si thua? — e pyeti me një zë të ëmbël plaku, pa e pasur edhe vetë të qartë pse e bënte këtë pyetje.

Delira u përhoq të fliste, po nuk nxori zë.

— Pse trembesh, moj nënë! — i tha Maria dhe me bisht të syrit pa nga i shoqi.

Delira, si të kërkonte ndihmë, kapi me vrull duart

e Maries dhe fillooi të dridhej, pa e përmbajtur veten.

— Nuk dua!... Nuk dua!...

Plakut i shkuantë rrëqethura.

«Ç'bëj kështu... ç'bëj unë kështu... Po tregohem më grua, se gruaja», mendoi Pali dhe një zemërim i hidhur e pushtoi për dobësinë e vet.

— Le të zgresim tani poshtë... Ti, — i tha me zë urdhërues së shoqes, — merr jorganin dhe gunën... Unë po mbaj Delirën...

— Dini!... Dini!... Ku është Dini?... Ç'u bë? Pse u vonua?... Ai s'do të lejonte të më zbritnit poshtë... Nuk dua!... Nuk dua!...

— Çupë e nënës, thëllëzë e nënës!... Mos u tremb, mos... se e helmon gjakun dhe e vret evlatin.

Ajo i tërroqi me rrëmbim duart nga plaka dhe ia dha të qarit. U kap me thonj pas dyshekut, sikur trembej mos e shkëputnin me forcë nga shtrati.

— Nuk dua të zgres në bodrum... Nuk dua.

Të dy pleqtë ngrinë në këmbë.

— Nënë, mos më lër vjetëm, ndihmomë... Nuk dua të zgres poshtë...

Palit fillooi t'i ftohej gjaku. U zbeh dhe sytë iu perdelisën. Ai ndjeu se do t'i binte të fikët dhe mblodhi gjithë forcat. Nëpër tym eci mbrapsht, u mbështet me kurri pas murit dhe rrëshqiti pastaj ngadalë në postiqen e leshtë, buzë oxhakut.

Maria, kur pa plakun në këtë gjendje, i shkoi pranë.

— Ç'ke?... Nuk je mirë?

— Nuk kam gjë... — tha plaku duke marrë frymë me mundim. — Asgjë... Pak ujë... — Dhe shtrëngonte me bërryl zemrën.

— Do të shtrihesh? — e pyeti Maria, që i pruri gotën e ujit.

— Nuk kam gjë... Si gjithnjë... zemra... më... do të kalojë. Mos u bëj merak për mua...

Maria mbeti tani si e hutuar. Nga njëra anë nusja që vuante nga dhembjet e lindjes dhe nga frika e bodru- mit të errët dhe, nga ana tjetër, plaku që vuante nga ze- mra dhe nga dhembjet që i shkaktonte frika e nuses.

Një copë herë në dhomë ra qetësia. Tutje u dëgjuan si rënkim tingujt e thellë të këmbanës. Plaku e kaloi kri- zën, u çua në këmbë dhe tha me vete: «Kam nevojë të këshillohem».

Shkoi pa u ngutur deri te pragu i derës dhe mbathi opingat.

— Ku shkon? — e pyeti Maria.

— Poshtë, — u përgjigj plaku, i ngrysur, — nga ki- sha...

III

Priftin e gjeti ulur në tavolinën katërkëndëshe prej arre, gati për të ngrënë drekën. Kishte shtruar përpara vezë të skuqura me gjalpë, djathë kaçkavall, bërxollë de- rri dhe një poç me verë. Në një tepsi të madhe kishte rrush dhe mollë.

— Të paska dashur vjehrra me shpirt! — qeshi pri- fti, kur pa Palin të hynte në dhomën e ngushtë e të gjatë.

Pali u ul i ngrysur në anën tjetër të tavolinës, ba- llë për ballë me priftin, pa thënë asnje fjalë.

«Erdha në kohë të keqe», mendoi dhe pa nga dri- tarja vezake, zbukuruar me zhama të verdhë, mavi dhe portokall.

— Bujrum në shtëpinë e zotit! — i tha prifti.

Pali tundi kokën.

— Nuk më shkon, — i tha mbyturazi dhe përsëri tundi kokën.

Nga dritarja shikohej livadhi, ku bari i pakositur arrinte deri në gjunjë. Mbi bajamet e qershítë këndonin gardalinat. Pak më tej, prej selvive të heshtura e të vemuara vinte zëri i trishtuar i guguçeve.

— Po mban vjeshta si behar, — tha prifti, duke mbillaçit me nxitim copa të mëdha. Merrte frymë me mundim, me gojën të hapur; duket, kishte mish të huaj në hundën e trashë e të kthyer si kërrabë. Prifti piu me fund një gotë verë, fshiu buzët qetë-qetë dhe psherëtiu nga kënaqësia.

«Është i kënaqur, se nuk ka hall», mendoi Pali dhe pati një ndjenjë shqetësimi e padurimi. «Sa do të vazhdojë ky njeri të hajë kështu?»

Ai dukej i gjëzuar. Vizita e papritur e Palit e pruri në qejf. Ferkoi me pëllëmbë një mollë të madhe, të verdhë dhe ia nguli dhëmbët me gjallëri.

— Sot pasdite më duhet të shkoj matanë lumi... Do të kungoj një vajzë... Pije dhe ti një gotë, — i tha Palit dhe i zgjati gotën e gjatë, mbushur me verë.

Palit iu drodh dora tek mori gotën. Ai kishte filluar të bëhej nervoz, se nuk e duronte dot kërcitjen e mollës, sa herë e kafshonte prifti.

E piu me fund.

— Është dhjetëvjeçare, — tha prifti. — Të mbush dhe një tjetër?

— Është e mirë, — përsëriti Pali, — shumë e mirë... po mos më hidh më... se nuk jam në gjendje... Ja, me këtë gotë dhe u turbullova.

Edhe para se të hynte këtu, Pali i ndiente tëmthat të trashë dhe ishte i hutuar, sikur të kishte ndenjur një javë pa gjumë.

Prifti u mbështet i téri pas shpinëzës së karriges dhe kérkoi t'i sillnin kafe.

— Dy, — i tha shërbyeses, që hyri në dhomë të hiqte mbeturinat e drekës.

«O zot, sa do të zgjatë kjo punë?» — rënroi Pali.

Prifti e pa me vëmendje fytyrën e zbetë të Palit dhe i tha:

— U mërzite?... E shoh se ke hall dhe nuk të priitet... po ja, pimë rehat-rehat kafenë, pastaj unë do të të dëgjoj ty... se ti ke nevojë të flasësh, të çlirohesh nga ankthi... apo jo?

Pali kapërdiu pështymën dhe tundi kokën.

— Ashtu éshtë, uratë...

Një copë herë, deri sa erdhën kafetë, ata qëndruan të heshtur, pa shkëmbyer asnjë fjalë. Pastaj prifti filloi ta rufiste me zhurmë kafenë gjithë ajkë.

«I shijon gjithçka, — mendoi Pali, ndërsa shikonte si i zgjaste prifti buzët që shkëlqenin nga lyra. — Ka edhe qejf të bisedojë, se nuk ka ndonjë hall».

— Ja dhe kjo drekë mori fund, — tha prifti.

Pali pati përshtypjen e çuditshme që urata i numëronte drekat që mbaronin, dhe kjo e trishtonte.

Prifti u mbështet pas shpinës së lartë të karriges, mbylli sytë, po tanë në fytyrën e tij nuk ndihej më ajo kënaqësia e mëparshme. Kur ai hapi sytë, Pali vuri re se fytyra e uratës ishte si e menduar dhe e rrëthuar nga hija e misterit.

— Tani mund ta hapësh zemrën, — tha ai me një zë krejt tjetër, të ftohtë e të thellë.

Pali nuk foli. Nuk dinte si t'ia fillonte. Gjatë gjithë kësaj kohe, siç ngjet zakonisht me njerëzit e tronditit thellë shpirtërisht, ai nuk pat menduar as për një çast

ç'do t'i thoshte priftit. Pak nga tensioni, pak nga lodhja, pak nga vera që piu kur barkun e kishte të zbrazur, ai nuk po përqëndrohej dot në lëmshin e mendimeve që i gumëzhanin në kokë. Nuk po e gjente fillin.

«Nga t'ia filloj», mendoi, ndërsa ndiente se qafa i qe tendosur përpara. Kjo e lodhte shumë. Prifti e pa përsëri me vëmendje dhe, nga eksperiencia e gjatë, e kuptoi plotësisht gjendjen shpirtërore të Palit.

— Në librin e shenjtë thuhet se, po qe se njeriu shkon, pa e kuptuar, drejt mëkatit, ahene ai nuk është mëkatar... — Dhe heshti, duke i dhënë kohë Palit të mendonte mbi atë që dëgjoi. Pastaj vazhdoi me të njëtin ton të thellë dhe pak të dridhur.

— Në librin e shenjtë thuhet përsëri: nëse njeriu, pasi e kryen mëkatin, e ndien thellë vuajtjen, pendohet dhe nuk trembet të fshehë asgjë, ai përsëri çlirohet prej tij... Biri im, ç'e keqe të ka ndodhur?... Hape zemrën... se këtu je në shtëpinë e perëndisë... Hape zemrën, biri im, që të shpëtosh nga ankthi...

Truri i Palit ishte bërë si xham i veshur me avull. Ai po përpinqej me të gjitha forcat të dilte nga ajo gjende dremitjeje.

Prifti kryqëzoi duart e bardha e të fryra dhe, duke e parë Palin thellë në sy, i tha:

— Fëmijët, nganjëherë, janë rrezik mbi supet e printit.

Ai kishte goditur në shenjë. Befas trurin ia përshkoi një kthjellësi e madhe.

«E ditka!», mendoi dhe, sikur të ishte lehtësuar nga një peshë e madhe, priti me padurim të vazhdonte.

Dhe prifti, sikur t'ia kishte zbuluar edhe këtë dëshirë, vazhdoi menjëherë:

— Djali yt, Dini, dhe nusja, Delira, nuk vijnë më në

kishë... Ata po largohen dita-ditës nga rruga e fesë...

Prifti lëshoi me këto fjalë pika helmi.

«Nuk ditka gjë!», tha përsëri me vete Pali dhe e la priftin të fliste.

— Djali yt, Dini, në vend që të vijë në kishë, shkon në vatrën e kulturës dhe atje, së bashku me të rinj të tjerë, tallet me mua e hedh pështymë mbi kishën.

Fytyra e priftit ishte zverdhur dhe në tonin e ftohtë e të thellë tingëllloj një notë zemërimi.

— Mëkati i fëmijës sonë është edhe mëkati ynë, në goftë se nuk e luftojmë atë. A është kështu, Pal Na-rok Sha-ti?

Prifti e ndau në rrokje emrin dhe e theksoi me tone të ndryshme çdo rrokje.

— Ashtu është, — u përgjigji Pali, krejt i hutuar dhë i tronditur nga ky lajm. — Po unë... nuk di gjë...

— Nuk di gjë?! — e pyeti gjithë habi dhe dyshim prifti.

— Zoti më vraftë, në di gjë... — tha plaku dhe bëri kryqin.

«Duket se me të vërtetë nuk di gjë, — mendoi prifti.

— Po është për t'u çuditur që e ka njeriun e tij, brenda në shtëpi dhe nuk ka marrë vesh gjë!... Kurse fjala vjen deri tek unë të më helmojë gjakun... Mos më kanë gënjer... Apo ka plasur sherri midis tyre?... Në ç'hall thua të ketë rënë ky plak, që është kaq shumë i tronditur?»

Prifti i mbylli përsëri sytë dhe u përqëndrua disa sekonda. Pali pa buzët e tij që lëviznin ngadalë dhe mendoi se urata po lutej. Në çast u kujtua se kishte një copë herë që rrinte këtu, pa thënë atë që duhej të thoshte.

«Po sikur... gjatë kësaj kohe ajo të ketë lindur?...

— i shkrepi papritur dhe kaq tepër e theri ky mendim,

sa, për një çast, deshi të ngrihej dhe t'ia mbathte me vrap për në shtëpi. Por, apo u bë gati të çohej, mendoi: «Në qoftë se ajo ka lindur... ka lindur... — përsëriti me vete dhe u habit përsë e trembte dhe nuk e gjëzonte ky fakt. — O zot unë, edhe këtu, brenda në kishë, në shtëpinë tënde, para priftit, mendoj gjëra të errëta dhe plot dyshim... Ç'pres akoma që nuk rrëfeshem?»

Prifti i çeli përgjysmë sytë dhe u përpoq shumë që zëri të tingëllonte sa më i qetë:

— Dinin ti e rrite me përkëdhelje të mëdha, sc i deshe dhe i do shumë fëmijët... Po zoti ty nuk të dha fëmijë!

«Zoti nuk më dha fëmijë...», pëshpëriti plaku me hidhërim.

— Dhe nipi, që ti e rrite me tërë të mirat... — prifti pa me kënaqësi se në fytyrën e Palit po reflektohej frika dhe nënshtimi ndaj misterit, — në vend që të të sillte lumturi, po të sjell... halle.

Fjalën e fundit e shqiptoi me grykë, pa i ndarë sytë nga Pali, duke dashur të zbulonte fuqinë e tij sygjesteive. Prej vitesh ai ndiente kënaqësi të madhe kur, njerezve që vinin të rrëfesheshin, u zbulonte hallet e tyre, pa e thënë akoma ata plotësisht. Prej 30 vjetësh prift në këtë kishë majë kodrës, rrethuar nga livadhet, vreshtat, pemët frutore e qipariSET, aji kishte arritur t'i njihët emër për emër të gjithë fshatarët e kësaj ane, të dinte dëshirat e dobësitë e tyre, grindjet, miqësitë, krushqitë, vdekjet e lindjet. Të njihë tokat që kishin marrë nga Reforma dhe sa prodhonin ato, gjënë e gjallë, vreshtat... Ai shkonte në shtëpitë e tyre sa herë e thërritnin, dinte të sillej thjeshtë, përpiquej t'u hynte sa më shumë në zemër dhe të blente sa më tepër të dhëna nga ato që thuhe-

shin përrch... Kështu, ai nuk e kishte të vështirë të zbulonte dramat e tyre.

Ja tani, edhe Pali, dalngadalë, po binte në rrjetën e tij. Diç i kishte ndodhur, po çfarë tamam, ai nuk po e zbulonte akoma. Mjafton që plaku të lëshonte një gjysmë fjale dhe prifti do ta shpiekste tërë lëmshin. Ai priti me durim, po Pali nuk e hapi gojën. Atëhere prifti pyeti:

— Mos je grindur me Dinin? — Picërroi sytë dhe shikimi iu bë depërtues.

— Jo... jo... — u përgjigj plaku. — Nuk kam pasur asnje grindje.

Prifti u çorientua plotësisht. Ndërsa shikonte si në-për mjegull mollëzat e kërcyera e sytë e mëdhenj të Palit, ai ndjeu se qe zemëruar shumë me këtë fshatar të pagdhendur, që nuk po e zbërthente dot. Ai e urrente familjen e Palit. Ai donte të hakmerrej me Dinin dhe me Delirën që talleshin me të, këndonin kuplete e lozni skeçe.

«Çfarë shkëmbi! — mendoi me përbuzje. — Është ngulur aty, dhe nuk flet. E përsë...» Ai e mblođhi shpejt veten, se gati qe duke i bërtitur. Pa nga dritarja dhe tha se, pas një copë here, do t'i lipsej të hidhej tej lumit...

«Vërtet po vonohemi», mendoi Pali pa ditur përsëri nga t'ia fillonte.

Priftin e mërziti kaq shumë heshtja këmbëngulëse, gati tallëse, e plakut, sa nuk duroi më, po pyeti haptas:

— Ahere?

Pali i hapi sytë më shumë se zakonisht.

— Fol, pra, ç'të ka ndodhur?!...

— Akoma nuk ka ndodhur gjë... — u përgjigj i turbulluar Pali.

Prifti i vari krahët poshtë i rraskapitür.

— Po, ahere... pse erdhe këtu? Apo ndoshta...

Pali e ndërpreu, sikur të trembej mos e harronte mendimin:

— Ajo... që mund të ndodhë sot... më ka ndodhur 40 vjet më parë.

Që në fjalët e para, priftit iu ngjall një interesim i madh.

— Vazhdo, biri im, vazhdo! — i tha dhe i bëri kryqin.

— 40 vjet më parë, — e mori përsëri fjalën Pali e filloj të fliste i sigurtë, — unë kam bërë një mëkat. Gruaja në atë kohë ishte shtatzënë. Kur i erdhi dita të lindte, unë, sipas zakonit, e zbrita në bodrum. Ka qenë dhjetor dhe atij moti ka bërë shumë ftohtë. Gruaja qante me të madhe, digjej nga zjarri i etheve, dridhej e tëra dhe më lutej e më lutej... Ndaj të gdhirë, kur zbrita fshehurazi në bodrum dhe nën dritën e qiririt pashë ftyrën e saj të verdhë, të verdhë, pa pikëzën e gjakut, thashë se kishte mbaruar. Po ajo i hapi sytë dhe më shikoi me aq lutje, sa unë nuk durova, po e mora në krahë dhe e ngjita në dhomën e zjarrit. Plaku u xhindos kur e pa shtrirë në dhomën e zjarrit. Më urdhëroi ta zbritja, po unë nuk dëgjova. Në mëngjes, pas mundimesh shumë të mëdha ajo e lindi fëmijën të vdekur. Një muaj lëngoi në shtrat, dhe nuk di si shpëtoi nga vdekja. Pas ca kohësh plakut i ra pika dhe vdiq. Kurse mua zoti më dënoi duke mos më dhënë fëmijë...

Pali heshti një copë herë dhe mori frymë sa u ngop, meqë kishte folur shpejt e pa ndalesa.

Priftit i mjaftoi ky pushim prej disa sekondash, që të bënte lidhjen e faktave.

— Dhe tani, pas 40 vjetësh, nusja është në prag të lindjes... — tha prifti, që Pali të vazhdonte.

— Po... po... — u ngut të përgjigjej Pali. — Tani, pas 40 vjetësh, ka ardhur përsëri koha që unë ta zgres poshtë në bodrum dhe, ... megjithëse dikur e bëra një gabim, që më kushtoi aq shtrenjtë, ... unë... akoma nuk e kam zbritur...

— Nuk të lë djali?

— Jo... jo... Dini ende nuk është kthyer. Por vetë... unë... nuk po mundem... më kupton, uratë?... Nuk e di, ky është mëkat i madh që unë të dal kundër zakoneve, por... por... një dyshim i zi më mundon... Më ngjan se ajo... ajo do të vdesë nga frika, po të zbre- së në bodrum...

Prifti e la sa të qetësohej, pastaj tha:

— Ky është mëkat, biri im...

Pali u zverdh në fytyrë dhe pyeti:

— Mëkat?

— Mëkat i madh, — përsëriti prifti.

Pali nuk foli.

— Ti je shtylla e shtëpisë. Ti je njeri i kishës. Ti duhet t'i mbash zakonet, qoftë edhe me... gjak. Kundër kujdo qoftë... Mos u tërhiq, edhe kur të kundërshtoj- në gruaja, nusja, djali...

Në fytyrën e priftit u përhap drita e kënaqësisë. Më nè fund, ai e zuri gjahun në rrjetë.

«Ja ku më erdhe në shteg... Tani di unë ç'do të bëj...», tha me vehte dhe fërkoi duart midis kofshëve.

— Kurse ti, kreu i shtëpisë, paske dorëzuar armët...

— Jo... jo..., — shtoi Pali, — akoma jo...

— Dyzet vjet të shkuar ti e shkele zakonin që na kanë lënë të parët dhe, si rrjedhim, nuk pate njëherë e përgjithmonë fëmijë... vrave dhe babanë. Ti ke vuajtur për shumë kohë nga mëkati. Mos do t'i hedhesh telashe të tjera vetes mbi kokë...? Kërkon të përsëritësh më-

katin? Bëre mirë, biri im, që erdhe të ndriçosh rrugën ku do të ecësh... Shpirti yt do të shpëtojë nga vuajtja e gjatë. — Dhe futi dorën në një poç. Pasi e spërkatit Palin, u çua në këmbë dhe bëri kryqin mbi kokën e tij. Pastaj e shoqëroi deri te porta. Kur Pali u largua, prifti thirri shërbëtorin e kishës, u mbyllën në qelë dhë bisëdoi me të

IV

Që nga pragu i derës Pali pa Marien, përkulur mbi sofër, tek tëhollte petët e byrekut. Mbi grumbullin c prushit të oxhakut piqeji në saç kulaçi. Era e athët e brumit dhe afshi i ngrohtë që notonte në tërë dhomën, i kujtuan Palit se së shpejti do të kishte mik në shtëpi, të kunatin. U kollit.

Maria, me llërën e lyer me miell, fshiu ballin dhe i bëri shenjë, si herën e parë, të hiqte opingat dhe të ecte me kujdes. Pali e pa i ngrysur dhe eci me hap të rëndë, duke shkelur me opingat e trasha dërrasat e vjetra që kërcitnin.

— Rënkoi sa rënkoi e shkreta, — tha Maria, ndërsa vazhdonte të tëhollte petët, — derisa, më në fund, e zuri gjumi... Veç ta shikosh sa e qetë fle!...

— I zbrite poshtë jorganin dhe gunën? — e pyeti Marien me zë të ashpër.

— Jo, — tha ajo me zë të pasigurtë, ndërsa shikonte fytyrën e vrenjtur të Palit. — Ti nuk më the gjë...

— Është nevoja t'i numëroj të gjitha?... Nuk e di ti që në bodrum bën ftohtë? Hë, ç'më rri si e shushatur. Çohu!

Maria fshiu miellin me përparëse, pastaj pastroi gishterinitë nga brumi dhe, ndërsa shikonte Palin, i vëtëtiu i njëjtë mendim: «Po sikur të zgresim ne poshtë dhe Delira të mbetet lart?»

— Ç'ke moj? — e pyeti Pali, kur pa që ajo pat ngirë në vend.

«Ruanja zot! Ah, sikur të mundesha t'ia thosha njëherë!»

Pali vuri re lëvizjen e buzëve dhe e kuptoi që ajo diç po fliste me vete.

«Mos po lutet? Është bërë meit, sikur . . . sikur . . . ,» dhe hodhi vështrimin përreth.

Maria po vuante. Në fytyrën e saj të zverdhur bujuan pika djerse. Kishte vënë tërë forcat që të mos ia thoshte atë që bluante, por dëshira që të çlirohej, po e torturonte.

«Do të tërbohet . . . do të çmendet . . . dhe, në fund, e tij do të dalë!»

Për pak sa nuk ra në këmbët e Palit, që t'i lutej ta linte Delirën aty . . .

— Marie! — Zëri i rëndë e bëri që të dridhej. Ç'ke?
... Mos ndill keq, grua!

— Unë? — Zëri i doli papritur dhe ndjeu gjësim. E kaloi krizën. Mendimi që e kishte torturuar, u zhduk përsëri. Si mund të lihej dera e hapur, kur frynte mur-lani?

— Ti po ndjell të keqen, grua! Ne presim lindje, jo vdekje.

Sytë e Maries u zmadhuan.

«Presim lindje . . . lindje . . . ,» përsëriti ajo me vete, pa e shqiptuar asnjëherë fjalen vdekje, që rrinte aq pranë.

— Dëgjove? — e pyeti ai.

— Dëgjova.

— Pse nuk tundesh nga vendi?

Ajo iu bind urdhrit. Hodhi mbi supe jorganin, gu-nëن dhe u mat të zbriste poshtë, por, me të arritur në mes të dhomës, qëndroi dhe tha:

— Po sikur...

— Çfarë! — Fishkëlleu nëpër ajër si presë shpate: «Çfshshsh!»

Maria shtangu përsëri. Si është e mundur që i kish-te ardhur i njëjtë mendim në majë të gjuhës?!

— Zbresim ne poshtë... burrë... dhe Delirën e lëmë lart...

— Mbylle gojën, grua!

— Mos e vrasim thëllëzën me duart tonë, burrë!

Ajo po i lutej. Valë të ngrohta vinin dhe goditnin zemrën e Palit. Futeshin në kraharorin e tij të madh nga të gjitha poret dhe e zbutnin, e zbutnin...

«Dang... dang... dang...», i rrihte zemra. Dhe kumbimet përhapeshin në një hapësirë të pafund. Tani e kishte fjalën zemra, së cilës i trembej aq shumë. Ajo komandonte.

Hodhi përsëri shikimin përreth. Ai deshi të zbulonte ku qe fshehur ajo forcë e padukshme që i komandonte zemrën.

Dang!... Dang!...

Tutje binin këmbanat e kishës. Zëri i lartë, i mister-shëm, i frikshëm, erdhi nga muret e zeza të kishës dhe e shtypi kraharorin e Palit. Zuri të gulçonte.

— Po na shtyn drejt mëkatit, grua... Dëgjon? Po më shtyn në mëkat...

— Mëkat është të vrasim nusen, burrëziu!

— Aaa... ashtu, a... Ti do të më trembësh, a... Dhe do... si dyzet vjet më parë... të vrasim sërisht me duart tonë foshnjën... Harrove?

Maria u drodh.

— Unë nuk kam harruar asgjë, burrë, asgjë... Se unë i kam ndier të gjitha mbi kurriz. Fëmija vdiq, se ti më zbrite të lindja poshtë, si një lopë... Zakoni më coi në buzë të varrit e ma thau barkun njëherë e përgjithmonë... 40 vjet me radhë... mijëra herë kam dashur të ta them, po i jam trembur zemërimit tënd... Dhe tani... tani... unë nuk doja të ta thosha, po nuk munda, sepse... po vrashim...

— Pusho! — klithi Pali.

— Besomë mua, Pal, unë jam grua dhe unë e di ç'heq gruaja kur lind... Ti nuk ke faj... mos i beso atij... priftit.

Te Pali nuk mbeti asgjë tjetër, veç ndjenjës së tèrbimit. Ajo qe kaq e fortë, sa ai gati u paralizua.

— Zhdukmu sysh! — i tha dhe u mbështet pas murit.

— Nuk është mirë kështu, nuk është mirë... Hiq dorë...

— Dëgjo këtu ti! Sikur tèrë dynjaja të më dalë para, unë nuk do të tèrhiqem si atëherë me ty... Shko tani...

Maria u çua në këmbë.

— Do t'i kisha vënë pishën shtëpisë, para se të merrte erë fjala jote...

Maria përsëri hodhi në krahë jorganin dhe gunën. Ajo ishte e sigurtë që Pali do të vepronte siç kishte thënë. Kur arriti në prag të derës, ktheu kokën nga ai.

— Meqë nuk bëhet ndryshe, ahene me të urtë, burrë, me të urtë... se është gjynah prej zotit. Ka kaq frikë... — Po nuk e mbaroi fjalen. Midis vetullave të Palit u formua rrudha e thellë dhe ftyra iu skuq.

— Qëromu sysh!... — Lipsu, të thashë! Ç'më rri roje te dera... Apo kujton se po më kthehet mendja.

Filloi tē dridhej. Sa dëgjoi që Maria po zbriste shkallët, u kthye nga Delira dhe vuri re që ajo ishte zgjuar. Sytë e Delirës qenë krejt tē qetë. Nuk shprehnin më frikë, veç një lodhje tē madhe.

— Je gati? — e pyeti plaku

— Po, — iu përgjigj ajo ftohtë.

— Çohu, ahere, se po erret.

Delira u çua ndenjur, mbuloi gjoksin me batanije dhe i tha:

— Më jep pak trikon ta vesh. — Zëri i tingëllonte çuditërisht i shtrirë, pa asnjë dridhje, i ftohtë e mospërfillës.

Plaku i dha trikon dhe, ndërsa e shikonte tē vishej, vërejti i habitur se ajo nuk po i lutej dhe nuk po qante si më parë.

— Mund tē ecësh vetë? — pyeti kur pa që ajo ishte bërë gati.

— Po, — u përgjigj dhe sakaq u_ngrit me mundim.

— Mundem.

Plaku e kuptoi ç'forca tē mëdha i duheshin asaj tē mbahej në këmbë. Deshi ta mbante pér krahu, po ajo ia largoi dorën.

— Lërmë! — i tha po me atë ton, ku ndihej krenari dhe përbuzje.

Plaku uli sytë dhe vetëm atëherë vuri re që Delira ishte zbathur.

— Ku i ke çorapet?

— Nuk është nevoja, — u përgjigj Delira dhe nisi tē ecte duke u lëkundur paksë.

Plaku tundi kokën dhe tha me zë urdhërues:

— Mbathi!

Pa thënë asnjë fjalë, Delira u kthye, gjeti çorapet e leshta me ngjyra i mbathi duke rënkuar dhe shkoi

drejt derës. Kur doli në krye të shkallëve, drita e fortë e goditi menjëherë në sy. U mbështet pas murit dhe do të ishte rrëzuar, po të mos e kishte kapur plaku për krahu. Siç rrinte me sy të mbyllur, ndiente ta rrëhonte një bardhësi e dendur. Pastaj i hapi sytë dhe tha:

— Sa shumë dritë!

Në fytyrën e saj të zbetë u vizatua një buzëqeshje e trishtuar.

Andej, nga fundi i shkallëve, ajo qëndroi të mbushej me frymë dhe e pa plakun në sy. Ishte e pamundur të përcaktoje çfarë shprehte ky shikim: as urrejtje as frikë, bile as përbuzje. Ndoshta lodhje... Ajo e shikon-te plakun nga larg, si një njeri të panjohur, me të cilin ishin këputur të gjitha pikat e afrimit.

— Pse po më mundon? — pyeti ajo.

— Si?! — pyeti plaku, i habitur deri në hutim.

— Po më mundon, — foli Delira po me atë ton. — Kurse unë s'kam mundësi të mbrohem... Nuk është Dini...

Papritur plaku e shtrëngoi kokën e Delirës në kraharon.

— Mos mendo ashtu, — i tha. — Si mendon kaq keq... përmua që të dua si fëmijën dhe kaluar fëmijës!...

Zëri i plakut i erdhi i largët, si jehonë. Ajo zbriti shkallët duke parë përpara, në boshllëk.

Kur arriten para derës, trupin e saj e përshkoi një e dridhur. Po përsëri nuk thirri dhe nuk u lut. Shtyu derën, përkuli kokën dhe u fut brenda. Vetëm një çast fare të shkurtër qëndroi në prag, mbështjellë nga mugëtira e ngjeshur e bodrumit dhe zuri të ecte drejt qiririt të ndezur. Kishte përshtypjen që këmbët i shkelnin në boшllëk, pa takuar në tokë. Ekte shumë ngadalë, me një

ngathësi të panatyrrshme, me gjunjët pak të thyer, me kokën që i lëkundëj, duke i shkruar herë pas e herë para, pa vështruar asgjë, veç flakës së qiririt, vënë mbi plakën e gurit, sipër shtratit të drunjë. Po ajo kishte përshtypjen se ecte shumë shpejt drejt dritës që lëshonte qiriri.

Pa u menduar asnjë çast, me të arritur pranë shtratit, hoqi trikon dhe u shtri.

— Tani mund të ikni, — tha ajo me sy të mbyllur, — jam e lodhur dhe dua të fle.

Të dy pleqtë nuk bënë asnjë lëvizje. Në atë dritë të mugët ata dukeshin si dy statuja të lashta, harruar prej kohësh në këtë bodrum të errët. Papritur Palit iu thyen gjunjët, u gërmuq i téri dhe zuri të dridhej. Maria nuk bëri asnjë lëvizje. Pastaj ai, pa thënë asnjë fjalë, doli jashtë, dhe vetëm tani Maria u afrua te shtrati. Pa e parë, ajo e ndiente që Delira qante heshturazi. Zgjati dorën dhe i fshiu faqet e lagura.

— Shko, nënë, shko... nuk kam frikë.

Maria vazhdonte t'i fshinte faqet.

— Dëgjon? Shko tani... Më vjen për gjumë... I ktheu shpinën dhe nuk foli më.

Maria u largua mbrapshët deri te pragu i derës dhe, sa po bëhej gati të dilte, u kthyesh rrëmbimthi, ra në gjunjë pranë shtratit dhe zuri të qante me ngashërim... Pastaj heshti dhe dëgjoi se si kërciste tavani. I ngjante se atje lart lëvizte me plogështi një ari i madh. Veshët e saj gumëzhiq. Po kërcitnin eshtrat e kullës së plakut...

Ajo u çua në këmbë, zgjati qafën dhe pa që Delira kishte rënë në gjumë të thellë. Doli jashtë, futi kokën përsëri të mbante vesh dhe vetëm pas një copë here u ngjit lart, nëpër shkallët e drunjta, mbështetur pas murit. Kur u fut në dhomë, vuri re se Pali kishte hequr

kulaçin nga zjarri dhe e kishte lënë në qoshe të murit. Vetë ishte mbështetur pas jastëkut dhe e kishte zënë gjumi me dorën e majtë të përthyer që shtrëngonte zemrën. Mbi fytyrën e tij binte drita e zjarrit. Si duket, kishte pasur dhembje. Mjekra i qe zgjatur në mënyrë të çuditshme dhe gropëzat e faqeve i qenë thelluar aq shumë, sa ngjante sikur ishin takuar njëra me tjetrën. Brenda një dite ai ishte dobësuar sikur të kishte lënguar një kohë të gjatë në shtrat.

Maria mori ca djathë, vezë, një tas dhe u përkul së-rish mbi petat e tëhollura. Si nëpër ëndërr, zuri të shtronte byrekun. Edhe asaj i vinte shumë gjumë, dhe e ndiente veten të rraskapitur, por byreku duhej pjekur, se ja... prite kur të vinte i vëllai. Veç kësaj, do të bënte edhe hasude...

Nuk e dëgjoi kur Dini u fut në dhomë. Ktheu kokën vetëm kur dëgjoi të thoshte:

— Of, ç'erë e mrekullueshme!

Lëshoi hejbetë e mbushura me harxhe dhe fërkoi me gëzim duart.

— Nuk ka ardhur akoma daja?

«Si do t'ia them?», mendoi plaku, ndërsa e shikonte kaq të gëzuar.

Papritur Dini mbeti si i ngrirë; kishte parë Palin mbështetur në jastëk, dhe fytyra e tij e shtrembüuar nga sforcimi e trembi.

— Ç'ka baba?! - pyeti dhe shkoi me vrapi pranë tij.

— Pati një krizë, — iu përgjigj Maria. — Shikoje si është bërë...

— Kur kështu? — pyeti gjithnjë i shqetësuar Dini, pa vendosur në duhej ta zgjonte të atin, apo ta linte të flinte.

«A t'ia them tani? », mendoi Maria dhe një copë

herë qëndroi mëdyshas, duke kafshuar buzën me dhëmbë.

Dini pa nga nëna.

— Çfarë ke? — pyeti i shqetësuar dhe menjëherë e parandjeu se diçka mund të kishte ndodhur.

— Qeparë... u trondit shumë... — tha Maria, duke vënë tërë përpjekjet të përbante vajin që i qe ngjitur në grykë.

Fytyrën e Dinit e mbuloi një zbehtësi e thellë. E kapi nënën me rrëmbim për krahu dhe e pyeti:

— Pse u trondit?... Çfarë ka ndodhur?... Ku është Delira?

Maries iu drodhën buzët. Ajo trembej të fliste, se ja, me të hapur gojën, do t'ia plaste të qarit. Po përsë të qante? Asgjë e keqe nuk kishte ndodhur. Ç'ishte kjo gjë e zezë që e kishte mbuluar shtëpinë?

— Ku është Delira? — bërtiti Dini i nxirë në fytyrë. — Mos i ka ndodhur gjë? Fol!...

Pali hapi sytë dhe vështroi të dyja hijet që bisedonin, pa kuptuar asgjë. Në ndërgjegjjen e tij kishte rënë shumë mjegull.

— Poshtë, — tha plaka.

— Ku poshtë?

— Në bodrum...

— Ç'bën në bodrum?! — pyeti me habi dhe ankth.

— E zunë të prerat...

— Po pse në bodrum?!... Ç'keni bërë kështu!...

— tha dhe u lëshua poshtë.

Pali, u çua në këmbë dhe vështroi përreth, i zbetë, i pafuqishëm, me një ankth të madh, sikur kërkonte të zbulonte diçka shumë të shtrenjtë, që nuk po i kujtohej ku e kishte fshehur. Dalngadalë kujtesa iu kthjellua dhe

shikimi i ngriu mbi të shoqen. Ajo kishte kryqëzuar duart në kraharor dhe kishte mbetur e shtangur.

— E?!... Mos zbriti në bodrum? — pyeti me një zë të çjerrë që i dilte me mundim nga gryka e përzhitur. Sytë iu zmadhuani dhe koka filloj t'i dridhej.

Duke u lëkundur sa në të majtë, në të djathtë, si të ishte i dehur, zbriti shkallët, duke bërtitur, me sa kishte në kokë:

— Për perëndi, nuk do ta lë, sikur bota të përmbyset...

Dini, i skuqur nga zemërimi që nuk po mundte të hapte derën (në nxitim e sipër, me sy të errësuar, në vend që të shtynte atë kanat që hapej shtynte tjetrin), sapo pa të atin që po zbriste shkallët, i doli para dhe klithi:

— E paskeni mbyllur me dry, ë?... Që të mos më lejoni të hyj brenda... Ç'keni bërë kështu... ç'keni bërrë... — Fërgëllonte dhe shkundej i téri nga zemërimi. Buzët i qenë zbardhur.

— Bëhu burrë! — i tha me zë autoritar Pali.

— Nuk më duhet burrëria... Ptu!... Pështyj mbi këtë burrëri. Zakoni ju ka verbuar... Ju po e mbytni Delirën... Çele derën! — u çor dhe zuri të kërkonte me sy rrëth e rrotull.

Plaku i pat shtrënguar fort nofullat dhe e shikonte atë me ngulm nën vetullat e trasha, pa iu dridhur qepallat.

— Të janë errur sytë... çapaçul! Dera éshtë e çelur, po ti përmore brekët sa dëgjove që gruaja ka zbritur në bodrum... Çfarë dreq burri je ti, që bie përbys për kurrgjë. Mblidhe veten, djalë, se éshtë turp!

— Turp éshtë kështu... siç po bën ti. Pse e keni mbyllur brenda? — dhe u lëshua drejt derës.

Pali po e përbante veten me mundim të madh. Gju-

njët sikur i qenë fryrë dhe i dhembnin. Edhe gjuhën e ndiente aq të trashë, sa e kishte shumë zor ta lëvizte, për të shqiptuar fjalët.

— Shurdhove dynjanë, që u shurdhofsh, or i mallëkuar! ... A nuk mendon se i fute tmerrin me këto të thirrura? — i tha Dinit.

Nga brenda u dëgjuan të qara dhe britma frike:

— Dini!... Dini!!!

— Ja se si hapet dera, o i verbuar me sy në ballë, — i tha Pali me përbuzje. — Urdhëro, bujrum, zotnisë sate dhe lëshoje zërin tani në kupë të qiellit, që ta marrin vesh të gjithë sa trim je! Hajde!...

Dini u pre i téri. Ai e pa babanë me krahët të varur dhe me gojën gjysmë të çelur... U bë flakë i kuq dhe një copë herë qëndroi i mbërthyer në vend. Pali e kapi për krahu dhe e futi brenda.

— Qetësoje tani... se ia bëre gjakun ujë, — i tha me zë të rëndë.

Delira qe mbledhur në anë të dyshekut dhe përpelitej e qante me ngashërim.

— Dini... Hajde këtu... hajde më pranë. Kam frikë për... ty. Pse thërritje qëparë? Ç'pate që goditje derën?... Mos u shqetëso... për mua. Nuk ka gjë. Unë... u mësova... Veç... ti... ti... — dhe zuri të qante.

— Dëgjon, Dini... Unë jam mirë...

— Erdha të të marr, — tha Dini me zë të thatë.

Dalngadalë Delira pushoi së qari dhe në bodrum under një heshtje e tendosur.

— Do të të çoj sipër, — i tha. — Vendi yt është lart, midis njerëzve. Vishu!

Maria mbuloi fytyrën me duar dhe, me gjithë përpjekjet, nuk mundi ta përbante rënkimin:

— O zot, na ruaj nga e keqja!

«Mbroje zakonin!... me çdo kusht.. edhe me gjak... kundër kujdo qoftë», përsëriti me mend Pali.

Ajo pa me bisht të syrit se si filloj të dridhej koka e Palit dhe në ballë iu formua një rrudhë e thellë.

— Po të pres, — i tha, gjithnjë me zë të ftohtë, Dini. — Pse rri e heshtur?

Delira i dëgjonte fjalët e Dinit, po nuk guxonte të vepronë, se e ndiente që do të shpërthente përsëri fur-tuna; kësaj radhe akoma më e egër dhe nuk dihej ç'pa-soja mund të sillte.

— Vishe! — thirri më në fund Dini, duke i hedhur në fytyrë trikon. — Pse dridhesh kështu...

Nga qoshja e bodrumit erdhi zëri i trashë e i rëndë i plakut:

— Mos luaj vendit, nusja e shtëpisë!

Dini u kthye nga Pali dhe në fytyrën e tij, mbi të cilën binte drita e qiririt, u reflektua ngjyra e dheut. Ai e ndiente veten tashmë kaq tepër të poshtëruar, sa nuk dinte çfarë mund të bënte, që të qetësonte ndërgjegjjen.

— E ke kot... Ajo do të vijë sipër, sepse... — ai filloj të dridhej përsëri dhe zëri e humbi natyrshmërinë,

— sepse ajo është njeri... nuk është kafshë... dhe ti...

— Mbaje veten!...

Plaku pati një ndjenjë të çuditshme. Në çastin që Delira rënkoj së thelli, atij iu duk sikur barku iu fut aq shumë përbrenda, sa u puq me kurrizin. U përkul përpara nga dhembja, po gjeti aq forca, sa të mos rrëzohej. Vuri të dyja duart në bark dhe e drejtoi trupin.

— Ti... ti..., — vazhdonte të therriste Dini, — nuk ke të drejtë të japësh urdhra të tillë...

— Sa jam unë gjallë... në këtë shtëpi... Do të bëhet... — dhe, me gjithë sforcimin, nuk mundi ta mbaronte mendimin. U përkul përsëri, qëndroi ca caste

thyer mbi gjunjë, pastaj ra përdhe. Po edhe i shtrirë, ai përpiquej akoma ta mbaronte mendimin, derisa e humbi vetëdijen . . .

V

Kriza qe e fortë. Ai u shtri në fillim brinjazi. Dy-tri herë trupi iu hodh pupthi përpjetë, pastaj e lanë fuqitë. Ra në kurriz, me krahë të hapur dhe nuk bëri asnjë lëvizje. Muskujt e fytyrës, që deri një minutë më parë ishin të tendosur, u shkrythën. Tani vëmendja u zhvendos nga Delira, që rrinte shtrirë në shtrat, te Pali, që rrinte shtrirë pa ndjenja, në tokën e ftohtë.

Një copë herë si Maria, si Dini ngrinë në vend, me vështrimin të ngulur te Pali.

— Babë! — i thirri Dini, — Babë . . . O babë! . . .

Zëri fluturoi në bodrumin e ftohtë.

U përkul, e mori në krahë dhe ky kontakt i ngjalli një keqardhje të madhe. Në gjakun e tij depërtoi dashuria e vjetër dhe ndjeu të rrëqethet. Dikur i ati e merrte atë hopa . . .

«Pritnim një lindje, — mendoi, ndërsa ngjiste shkallët me Palin në krahë, — na sillet vërdallë vdekja . . .»

E lëshoi Palin në dyshekun ku qe shtrirë një orë më parë Delira, dhe e mbuloi me batanije.

«Koka është mirë t'i rrijë e zbuluar, se i merret fryma», tha me vete Dini dhe e tërhoqi pak poshtë batanijen. Qëndronte në këmbë, mbi Palin dhe shikonte se si ai gulçonte gjithë mundim. Lotët që i patën rrjedhur, i kishin lënë gjurmë në rrudhat e faqeve. Dini u përkul në gjunjë dhe ia fshiu sytë e faqet.

«Plak i gjorë, — tha me vete, — po vret veten . . .»

E zuri për qafe dhe filloi t'i fërkonte damarët.

«Po i kalon», mendoi.

Iu kujtua sjellja e tij, me hollësitë më të mëdha. Vëçanërisht u trondit kur solli ndër mend çastin kur u zu me të para derës së bodrumit.

«S'kam bërë mirë. Duhej ta kisha bindur me të urtë... Jo ashtu... Edhe babai s'do të ketë qenë në vete kur e zbriti Delirën të lindë në bodrum...»

Dini zuri fytyrën me duar. Atëherë iu kujtua që Pali e kishte rregulluar për bukurin bodrumin. Pra, ai kishte menduar gjatë për këtë.

«Si është e mundur që babai, që merakosej aq shumë për shëndetin e Delirës...», — ndjeu se përsëri po i ndizzej gjaku dhe e kuptoi që nuk ishte e lehtë të sundonte veten, kur mendonte që Delirën e kishin zbritur në bodrum.

«Po kjo nuk durohet!»

Kërceu në këmbë. I rrithnin tëmthat dhe grushtet i pat shtrënguar aq fort, sa i dhembnin gishtërinjtë. Kundër kujt mund të shfrynte zemërimin? Uli kokën dhe pa fytyrën e zbetë të babait.

«I ka rënë hija e vdekjes...», iu kujtua papritur.

Maria hyri në dhomë.

— E zuri gjumi, — tha.

Dinit iu deshën disa sekonda që ta mblidhët veten.

Për kë e kishte fjalën? Për Delirën?

— Po fle? — pyeti, pa u kuptuar në e gëzonte ky lajm.

— Po... Para se të flinte, pyeti si është baba...
dhe m'u lut të të thosha, që të mos grindesh më me të...

— Nuk tha gjë tjetër? — pyeti përsëri Dini, sikur deshi të sqaronte një dyshim.

— Jo, jo, veçse m'u lut të mos grindesh...

— Nuk kérkoi... t'i shkoja pranë?

— Biri im, — i tha Maria me zë të ëmbël, — kur gratë janë në prag të lindjes, nuk është mirë që burrat t'u rrinë mbi kokë.

Ai ndiente një dëshirë të madhe të zbriste poshtë, ta merrte në krahë Delirën dhe ta sillte në dhomë, siç bëri edhe me Palin. «Kush është më keq, Delira, apo babai?»

— Thuamë të drejtën, si është? ... Mos më gënje!
— Zéri i tingëlloi lutës.

— T'u bëftë nënëlokja, e si do të të gënjej... Më vraftë zoti, në të gënjej!... Ajo është qetësuar dhe ka rënë në gjumë të thellë... Bile i kanë pushuar edhe dhembjet... Unë do të jem gjithnjë pranë saj.

Dini nuk foli.

— Mos ki merak, bir!

Dini rrinte në këmbë dhe shikonte me ngulm në boshllëk.

— Të gjitha gratë ndiejnë dhembje... Kudo që të jenë, — donte ta qetësonte Maria.

«Kudo që të jenë... — përsëriti Dini me vete. — Ç'duhet të bëj tanë? Po ta sjell Delirën lart, babai, me t'i hapur sytë, do t'i mbyllë prapë. Zakoni peshoka sa vdekja...»

Ndërkohë Pali përpéliti qepallat dhe, më në fund, i hapi sytë. E pa Dinin tepër larg, turbull, megjithatë gjëja e parë që i erdhi ndër mend të pyeste, ishte kjo:

— E hipe lart?

«Edhe në krizë të vdekjes, ai ka pasur këtë merak», mendoi Dini.

— Jo, — u përgjigj dhe ktheu kokën anash.

Pali u çua ndenjur dhe me shaminë e madhe fshiu ballin dhe flokët e qullur nga djersa.

— Hajde pranë babës! — i tha Dinit me dashuri.

I hodhi krahun në qafë dhe i tha:

— Mos ki frikë... Bëje këtë për mua... nuk do të ndodhë gjë e keqe... Unë jam plak dhe i trembem syrit të keq...

— Ajo vuan atje. Përse të sillemi kështu, babë?

— E do zakoni, bir.

— Ky është zakon i egër, babë.

— Zakoni është zakon, bir. Unë provova një herë ta thyeja dhe...

— Ky është zakon i egër, babë. Si ujku që kafshon gengjin. Të kanë gënjer, babë...

— Mbështetë ashtu si thua ti... por unë jam plak, biri im... A i shikon trarët e tavanit? Ata i ka nxirë tymi i viteve... Erdhi Tonini?

— Jo, nuk ka ardhur, — u përgjigj Maria që po dil-te jashtë.

Dini e kuptoi që babai deshi të ndërronte bisedë.

— A e di pse e kam ftuar Toninin për darkë? — iu drejtua Dinit. — Për punën e shtëpisë... Ku thua ti ta ndërtojmë shtëpinë e re?

Dini nuk iu përgjigj menjëherë. Si duket, Pali kish-te harruar që e pat lajmëruar që në mëngjes për ardhjen e Toninit.

«Do të ndërrojë bisedë», mendoi përsëri Dini, duke parë nga dritarja.

— Si të them... Mua do të më pëlqente ta ndërt-onim afër bajameve...

— Kështu them edhe unë...

Maria zbriti në bodrum. Tutje dëgjohej kënga e gë-zuar e artisteve të ardhur nga Tirana.

Pérpara Toninit shtruan tepsinë me tē ngrëna. Rakinë e shërbente Pali, kurse mishin nē hell e rrrotullonte herë Dini, herë Maria.

— Pér këtë raki njeriu mund tē bëjë dy ditë rrugë, — tha Tonini dhe rrahu me shuplakën e madhe gjurin. — E pi, dhe shpirti tē bëhet dritë.

Ai e piu me fund gotën dhe ndjeu se as rakia, as zjarri, sa mishi që po piqej mbi prushin e madh, nuk e ngrohnin. Diç kishin këta njerëz, diç u kishte ndodhur ... Ai shikonte herë Palin, herë Dinin, herë Marien dhe, nga mënyra si flitnin, si qeshnin, si heshtnin, ai zbuloi që nē këtë shtëpi vërtitej një hije e zezë.

Tonini çmendej pas ahengjeve. Vitet e para tē Çlirimt, kur shteti ndihmonte me kredi tē ndërtoheshin shtëpitë e shkatërruara nga lufta, ai bridhte nga një krahinë nē tjetrën, punonte herë këtu dhe herë atje, fitonte mjaft, i rraste tē hollat nē xhepin e thellë si torbë, po nuk vuri që nuk vuri gjë mënjanë. Dërgonte sa u lipseshin nē shtëpi dhe tē tjerat i bënte rrush e kumbulla nëpër ahengje. Dhe nuk u pendua kurrë që i harxhoi paratë pa vrarë mendjen tē vinte kapitale nē jastëk. Një ditë, e shoqja, duke u ankuar, i kishte thënë:

— *S'bëre që s'bëre prokopi, mor burrëziu!*

Ai qeshi me tē madhe.

— *Prokopi!... Unë nuk kam bërë prokopi! Ihhh!*
Sikur tē më ktheheshin nē vite shtëpitë që kam ndërtuar unë, do tē tē varrosja dy herë ty...

— *Tē tjerët kanë mbledhur tē holla...*

— *Llafe... e ç'i duam? Tani toka as nuk blihet, as nuk shitet... Tē blejmë bagëti? Mos do tē bëhem i kulakë.*

Kurse këtu, në shtëpinë e së motrës, me raki e meze përpara, nuk ndizej biseda. Ç'hall, thua, kishin? Papritur atij i ra ndër mend që nuk e kishte parë Delirën. Ku ishte Delira? Mos kishte të bënte me Delirën zymtësia që ata mundoheshin ta fshihnin? Deshi njëherë të pyeste, po ndërroi mendje kur kujtoi se, duke ngacmuar plagën, veç dhembjes, asgjë të mirë nuk ke. Kurse Tonini donte të buçiste e qeshura dhe kënga.

— Ti, Pal, po ma bën me hile... Sa e vë në buzë, kurse unë, dëng, e kthej me fund.

— Pali nuk ta bën me hile, mik vëllai... Po Pali, ti e di, është i sëmurë.

— Po, e di, Pal... Ahere le të pijë motra ime. Ktheje dhe ti një gotë, se s'ta zë fytin.

Maria piu dhe përqafoi të vëllanë. Kjo sjellje e papritur e habitit Toninin. «Dreq o punë», tha ai me vete dhe ia largoi duart nga qafa. Maria i ktheu shpinën, u gërmuq dhe qau.

— Ç'është kështu, xhanëm?! — nuk mundi ta përbante veten Tonini.

— Ç'pate moj!... Gratë, si gratë, — tha Pali dhe vështroi Marien me një zemërim që e përbante me zor.

Në gjunjë, pranë Toninit, u ul Dini.

— Unë e di, o Ton, që në të pirë nuk të del njeri. Por unë do t'i ngre disa gota me ty, se ti je daja im.

Ai hodhi tri gota radhazi. Tri gota hodhi dhe Tonini.

Hanin në heshtje. Dini mbushi gotat.

— Këtë gosti të vogël, — e mori përsëri fjalën Dini, pa e ngritur kokën, — do ta kishim bërë disa ditë më vonë, më të madhe... po baba të ftoi ty... pa e ditur ç'do të ndodhë...

— Ç'ka ndodhur?

— Asgjë... tani për tani... Presim... Baba do të ndërtojmë shtëpinë e re.

— Ai piu katër gota dhe Tonini e shoqëroi.

— E di, — tha Tonini.

— Unë edhe baba duam ta ndërtojmë te bajamet. Si thua ti?

— Mirë, mirë... e lëmë për më vonë bisedën për shtëpinë.

Pali mbushi gotat. Piu vetë dy gota, uroi, piu dhe një tjetër. Dini dhe Tonini e shoqëruan.

— Të bisedojmë tani, sa nuk na është nxehur koka,
— tha Pali.

— E lëmë për nesër...

— Atë që mund ta bëjmë sot, nuk është mirë ta lëmë për nesër.... Gëzuar!

Pali piu përsëri.

— T'u bëftë gjak e dhjamë! Bah, ç'raki!

— Ti, shko ndihmo nënën! — iu drejtua Dinit. — Shtëpinë e re dua ta kem sa më parë... — i tha Toninit.

— Këtë vit nuk bëhet.

Pali hapi dollapin dhe nxori një shishe tjetër. E fshiu me pëllëmbë dhe e lëshoi përdhe, midis gjunjëve.

— Pse?

Tonini piu nga shishja e re dhe papritur qeshi me të madhe.

— Kjo raki, për besë, të gudulis... ha, ha, ha. Lëre njëherë shtëpinë, hajde pimë pa halle mbi kokë... Hë, më të lumtë, ja ku na e shtruan dhe mishin... Pa ulu këtu, Din, edhe ti, Marie... Të kujtohet si ia mbanim dikur bashkë? Bilbila na quanin... Ikin, ore, ikin vitet... Hajde t'ia themi, Marie...

— Mbarojmë njëherë bisedën, — ndërhyri Pali. — Dhe lëre Marien.

Dini ngriti gotën dhe piu pesë dolli radhazi.

— Ç'bën kështu, Dini?! Të bisedojmë njëherë për shtëpinë. Do të dehem!

Maria u çua dhe zbriti në bodrum.

— Në djall të vejë shtëpia! — tha Dini.

— Në djall! — thirri Tonini dhe piu pesë gotat c rakisë.

— Jo, pra, mos merrni yrysh si çiliminjtë. Bisedojmë për shtëpinë ... Kjo është kryesorja.

— Kryesorja ... Nuk dimë ç'është kryesorja, babë!

— tha Dini, dhe sytë i shkëlqyen në mënyrë të dyshimtë. — Ç'është kryesorja, Tonin?

— Zure përsëri ti?! Dëgjo, Tonin ... A mund ta fillojmë shtëpinë këtë vjeshtë?

Tonini psherëtiu i lodhur.

— Jo, — u përgjigj shkurt. — Zënë shirat. Ku e ke gëlqeren, qerestenë, gurët? Pa grumbulluar një sasi materiali, nuk kam si t'ia filloj. Në pranverë marr ca ustallarë të mirë dhe brenda muajit e ke në këmbë kabinanë ...

— Deri në pranverë! — tundi kokën Pali.

— Të duket vonë?

— Për plakun, një vit është gjithnjë larg ...

— I ke rrënjet thellë ti. Nuk ikën kollaj nga kjo botë ... Kështu them unë, i ke rrënjet të thella ... ah, ah, ah! Pije me fund, Pal, lëre mënjanë shtëpinë, çoje go-tën, ashtu, të lumtë, Din ...

— Për çfarë rrënjet e ke fjalën ti? — pyeti Dini.

— Për rrënjet e Palit ... për jetën e gjatë.

«Ah ... po ... për rrënjet ... rrënjet ... Ku është filimi i rrënjeve ...»

— Kush, the, të këndojet? — pyeti Dini.

— Kush?! — pyeti Tonini dhe pa nga Dini me buzën në gaz.

— Ti! — u përgjigj Dini.

— Unë??

— Ahere Sulltan Pekmezi! Të pimë për Sulltan Pekmezin, urra! Rrënjet arrijnë deri te Sulltan Pekmezi...

— E ke njohur Pal, Sulltan Pekmezin? Përse i thonë Pekmez? Mos e hante shumë pekmezin, apo ia kanë lyer ndonjëherë, këtej nga ne, surratin me pekmez dhe ia kanë lëpirë Mizat? — tha Tonini.

— Ka ndonjë këngë për...

Papritur Dini u koll dhe lëshoi ca tinguji.

— Mos këndo, aman... mos këndo për Sulltan Pekmezin, — tha Tonini.

Dini e drodhi zérin dhe zuri të këndo...

«Sa sabah i bardhë qenka ky!»

Maria u duk në prag të derës.

— Marie, hajde pranë vëllait... Pse qan, budallaqe...

— Nuk po qaj, — tha Maria.

— Ah, kështu nuk dua. Shiko, shiko si po pi Pali dhe thotë... jam sëmurë, jiziti...

— Është ujë, — tha Pali.

— Ufff... ujë i bukur... Pi, vëlla, pi, ja dhe unë po pi... Këndo, vëlla, këndo!... Ja dhe unë po të shqëroj...

Truri i Dinit gjëmonte.

«Rrënjet dridhen e spërdridhen dhe zgjaten nëpër errësirë... Zgjaten e zgjaten e zgjaten... vijnë... nga vijnë?»

Dini u mundua të përqëndrohej. Tutje, matanë mureve të kullës, andej nga sheshi i fshatit binte daullja me një ritëm të shpejtë, dhe artistët hidhnin valle.

«Bum-bum-bum-bummm!», gjëmonte në trutë e Dinit.

Dikur rinia pat shkuar të hapte tokë të re.

...Ishte një pllajë e pjerrët, mbushur me ca pemë të shkurtra që i quanin kuce. Bënte vapë. Mbi tërë pllajën notonte një avull i verdhë përvëlues. Dikush i binte dauilles. Ata zhveshën këmishët dhe me sëpata, kazma u lëshuan mbi kucet. Qe një sulm i furishëm mbi këto pemëtrungje, që dukeshin sikur ishin ngulur aty qysh prej 500 vjetësh. Ato trungje të përzhitura nga vapa e kishin pustuar tërë pllajën.

— T'i zhdukim, t'i presim... t'i shkulim me rrënëjë.

Dhe ata qëllonin me forcë mbi kucet. Trupat e tyre u mbuluan nga djersët. U mbuluan nga afshi dhe, duke shkumëzuar, filluan të gërmonin për t'i shkulur ato rrënëjë. Dhe ata u çuditën kur panë se ato ishin trefish më të gjata se trungjet. Se ato dridheshin e përdridheshin nëpër gurë, nëpër guva dhe shkonin gjithmonë drejt errësirës. Ato ushqeheshin me errësirën. Por ata i zbulonin dhe, sado thellë që të shkonin dhe me sado marifete të ishin fshehur, i qëllonin tërë inat, i copëtonin, i shkulnin...

Lufta filloi në agim dhe mbaroi kur dielli nuk dukej. Tërë pllaja u mbush me kucet që u qenë prerë krahët, këmbët, kokat, rrënëjët.

— Të digjen!

Dhe i spërkatën me benzinë e u vuñë zjarrin. Kur flaka u ngjit në qiell, ata hodhën valle rreth zjarrit...

«Bum-buum, — gjëmonin tëmthat e Dinit. — Buum... rrënëjët duan vetëm errësirë. Ato futen në krahoror dhe na e shtrëngojnë zemrën... Na e shtrëngojnë... na e shtrëngojnë...»

Ai e pa veten në dhomën e vatrës së kulturës, mbushur me fshatarë. Qe ngritur dhe, i skuqur në ftyrë, tundte gishtin tregues që i dukej shumë i gjatë. Thoshte:

— Zakoni është... është... është (befas iu zgjidh gjuhha, fshiu djersët dhe shqiptoi me një zë të zgjatur e kercënues) si rrënjet. Këto rrënje vijnë nga errësira dhe qëndrojnë në errësirë.

«Bum... buum! Po më çahet koka... bum!...»

Zuri tëmthat me pëllëmbët e duarve, dhe filloj të gulçonte. Ai shikonte turbull se si pinte raki dhe shqyente mishin Tonini, ndërsa Pali fërkonte zemrën... Ftyrat e tyre qenë skuqur. Diçka po thoshin. Ndoshta këndonin.

«Ç'bën Delira?», pyeti ai veten midis hutimit dhe dhembjes që e shponte mu në thelli të veshëve, diku në tru. U mbulua nga djersët dhe befas ndjeu një dëshirë të çuditshme: të bërtiste me sa fuqi kishte...

VII

Gëzimi i madh dukej sikur gurgullonte nga toka. Në çdo goditje të daulles valltarët vërviteshin përpjetë.

Fshatarët qenë mbledhur në sheshin e shkollës, ngjeshur njëri pas tjetrit, ulur shesh, në gjunjë, në këmbë, mbi murin e shkollës dhe ndiqnin shfaqjen me vëmen-dje të madhe. Mbi tërë qenien e tyre peshonte kënaqë-sia. Ata ishin të lumtur. E ndienin thellë bukurinë e valleve e të këtyre këngëve që i kishin fëshfëritur më parë gjethet e plepave, çiftelitë dhe fyejt e tyre.

Pastaj, midis këtij gëzimi kaloi si hije njeriu i kishës dhe diç pëshpëriti. Një si fishkëllimë gjarpri, që

humbi në gjëmimin e duartrokitjeve. Kur entuziazmi po uloj, ai hodhi përsëri disa pika helmi mbi gjëzimin.

Fshatari u kthye nga fytyra e mprehtë, si teh thike, dhe e pyeti:

— Si the?

Fytyra e mprehtë i lëshoi fjalët nëpër dhëmbë: kështu e kështu.

«*U poq gruri nëpër ara*», këndohej në skenë. Në ajër ndihej fëshfërima e grurit. Melodia mblidhej e ëmbël në grykën e fshatarit. Sytë shkëlqenin.

Pikë-pikë pikonte helmi nga «fytyra» e kishës.

— Pali e ka zbritur Delirën në bodrum...

— Kush tha?

— Prifti.

— Ka plasur grindja në shtëpinë e Palit...

«*Kokrra e grurit të mos shkojë kot...*

Kur ta kemi plot hambarë...»

Fjala arriti deri te sekretari i partisë.

— Ku është ai? — pyeti sekretari.

— Aty pranë murit.

Ai rrinte mbështetur pas murit. Duart i kishte mble-dhur grusht para barkut. Kokën e kishte varur në sup dhe shikonte drejt skenës, si njeriu më i pafajshëm. Sekretari i shkoi pranë. Në profil fytyra i dukej tepër e hollë.

— Hajde pak me mua! — i tha me zë të ulët, por urdhërues.

— Përse? — e pyeti, dhe fytyra i mori shprehjen e një habie të madhe, sikur deshi të thoshte: «Unë jam shumë mirë këtu... Po dëgjoj me kënaqësi...»

Dy gra kthyen kokën. Sekretari i bëri shenjë të ndiqnin shfaqjen.

— Mos bëj zhurmë, — i tha njeriut të kishës. — Ec pas meje!

Tjetri psherëtiu dhe e ndoqi pa bërë zë.

*«Kur ta kemi plot hambarë,
Republikën e kemi të parë...»*

Në atmosferë zotëronte përsëri kënga dhe gjëzimi.

— Solle sihariq?! — i tha sekretari.

— Jo... — u përtyp njeriu i kishës, — erdha edhe unë të shikoj shfaqjen.

Ai fliste me zë të butë dhe shikonte si me dhembshuri.

— Të shikoje shfaqjen dhe të hidhje pikë helmi...
E pe ti, me sytë e tu Palin?

— E pashë kur u fut në kishë.

— E dëgjove bisedën e tyre?

— Jo...

— Nga e di ti... aherr... mor... që Pali e ka zbritur Delirën në bodrum?

— Më tha prifti.

— Nga e di ti që në shtëpinë e Palit ka plasur sherr?

Fytyra e mprehtë u hutua.

— Ty të tha prifti «Shko te fshatarët dhe thuaju kështu dhe kështu...»? Çfarë myzhdë kërkon të të jepim pér sihariqin?

Sekretari e pa atë me përbuzje. Qëndronin nga dhjetë metra larg sheshit ku jepej shfaqja, në një lirishte. Valët e melodisë dhe të gjëzimit vinin deri tek ata. Njeriu i kishës u mundua të buzëqeshte. «Unë jam i pafajshëm, — thoshte fytyra e tij, — jam i paditur...»

Sekretari u nervozua.

— Je një qelbësirë! — i tha. — Një qen i qelbur... Ç'pandeh ti, se ne do të vinim alarmin, me fjalët e para që na prure nga kisha? Ne e njohim mirë Palin dhe familjen e tij dhe, në qoftë se ka gabuar, nuk do të vëmë alarmin, jo, siç kurdis prifti, do ta rregullojmë, me qetësi, si dhe shumë ngatërresa të tjera që futni ju..., «njerezit e zotit»... Qëromu sysh!

Njeriu i kishës ngriu nga frika. Sekretari e kapi për jake të xhaketës dhe e shtyu tutje.

— Shko tani e thuaji priftit si mbaroi edhe kjo mesele...!

Njeriu i kishës ikte si hije nëpër muzg. Në ajër fluturonin tingujt e këngës «Jetë e bukur...»

VIII

Në oborr ndihej qartë melodia e gjëzuar që vinte tutje arës me misër. Herë pas here dëgjohej gjëmimi i dailles, përplasja ritmike e shuplakave, tingujt e fisarmonikës... Dhe toka ushtonte sikur mijëra këmbë rrithnin në të me gjësim. Pastaj, nëpër ajrin kristalor, akoma të kaltër, fluturonte kënga, që herë afrohej e herë humbiste në hapësirën e mbushur me aromën e ëmbël të vjeshtës. Ende pa u shuar mirë tingujt, dëgjoheshin thirrjet, shuplakat dhe zërat e gjëzuar të fshatarëve.

«Gëzohen», mendoi Maria dhe u drejtua nga dera e bodrumit.

Shfaqja do të vazhdonte edhe ndonjë gjysmë orë, pastaj artistët do të shpërndaheshin nëpër shtëpitë e fshatarëve. «Do të kishim marrë edhe ne dy a tre prej tyre, sikur Delira...»

Me të hapur derën, vuri re që Delira përpërlej në shtrat. Trembej.

Maria iu afrua me nxitim.

— Ç'ke kështu?! Pse trembesh, thëllëzë c nënës...
Jam unë, Maria...

Ia mori duart. Digjeshin.

— Pashë në èndërr gjarpër, — tha Delira dhe i shtrëngoi duart Maries.

— Mos u vër re èndrrave, të kcqen nëna... Qetësohu, se ja ku më ke mua.

Delira kishte parë në èndërr sikur pat ardhur të merrte ca kashtë në bodrum dhe, kur kishte lëvizur ca dërrasa, kishte parë që në kashtën e ngrohtë, si në një furrik, ishte mbledhur kulaç një gjarpër i zi. Delirës i kishte ngrirë gjaku. Gjarpri nuk kishte bërë asnjë lëvizje, vetëm se pat çuar kokën dhe e kishte parë Delirën ngultas, si i qe dukur asaj...

— Qetësohu, moj bijë!... — i thoshte Maria me zë të èmbël dhe i fshinte djersët.

Delira ishte në jerm. Zhurma e daulles ushtonte myturazi në kokën e saj të trullosur. «Bum! Buum! Buummm!»

Në dorë kishte ftuin, e rrrotullonte dhe shikonte të gjente një gur ku ta përplaste... «Do ta zbut mirë e mirë, pastaj do ta ha...» Filloi ta përplaste... Para saj, me duart në bel, qëndronie Dini dhe queshte me të madhe, duke u shkundur i téri.

Jashtë dëgjoheshin tingujt e fisarmonikës.

Maria u ul në shtrat dhe ia mbështeti kokën në prehër. I fshinte djersët nga balli dhe i përkëdhelte flokët e gjatë.

— Hapi sytë, moj bijë, të më shohësh, hapi...

Delirë u përmend.

— Më merren mendtë, nënëloke... Më duket sikur rrrokullisem e rrrokullisem tatëpjetë.

- Kështu ngjet me të gjitha gratë para lindjes...
- Dhe shoh ëndrra të frikshme... Çfarë ëndrrash!
- Bëj gajret, bijë, do të kalojë....

Ato mbajtën vesh këngën e gjuar që vinte andëj, tutje, nga shkolla.

- Kush këndon kështu?

— Kanë ardhur artistë nga Tirana... Është mbledhur tërë fshati.

— Ah, po!... Paskan ardhur... E kishim lënë... me Dinin t'i shihnim, — tha dhe buzëqeshi.

«Festojnë lindjen e fëmijës sime», mendoi Delira. Ky qe mendimi i parë i bukur, pas kaq orë vuajtjesh.

— Përse unë nuk kujtoj gjëra të bukura? — e pyeti Marien.

- Përpiku, bijë...

Dhe Delira u përpoq të sillte ndër mend kujtime plot dritë. Çudi, asnje kujtim.. I kishte harruar të tëra. Të tëra... Po dalngadalë, nëpërmjet asaj mjegulle, zuri të vezullonte diçka...

Një vijë uji kalonte nën kumbullat e kuqe e rrhidhët ngadalë. Në të dyja anët e bregut kishte bar dhe luledelle. Mbi degët këndonin gardalinat, kurse zhytur në pellg, nën gjethë, guaknin pa pushim një kor i madh bretkossash... Pastaj në vijë zbritnin rosat e bardha e të gjelbra me qafat e gjata, rrëshqitnin bukur e fare pa zhurmë, zhytnin kokën e pastaj tërë trupin deri në fund të ujtit e përsëri dilnin mbi bar e shkundeshin në diell...

Delira buzëqeshi. Ajo kishte kaluar kushedi sa çaste të bukura në jetën e vet, po kushedi pse i kutohej tanë tamam një çast kaq i parëndësishëm, krejt i harruar. Mjafton ta sillte ndër mend kohën e bukur që kishte kaluar me Dinin...

Njëherë... njëherë... Nuk mund të kujtonte asgjë.

I vinte tē qante nga inati. Si ishte e mundur t'i harronte tē tēra, sikur t'i kishte parë nē ēndërr? Tēmthat i qenë bymyer dhe kishte përshtypjen sikur qafa i pat shkuar shtrembër. Vinte tērë forcat ta drejtonte... Dhe kokën e ndiente si një lëmsh tē ngatërruar, tē përbërë prej miliona fijesh... I dhembnin sytë e digjej e tēra nga temperatura.

Njëherë... njëherë...

Delira filloi tē qante. Lotët e mëdhenj lagën duart e Maries, dhe ajo i tha me zé tē ëmbël:

- Qaj, bijë, qaj, se tē bën mirë, tē lehtëson...
- Nuk kujtoj asgjë, nënë...

— Sa tē qetësohesh... Nuk tē lë zjarri... Ke tē nxch-të, po sa tē qetësohesh dhe do tē shohësh sa tē duash gjëra tē bukura... Ahere nuk do tē kesh nevojë pér njerëz. Do tē kërkosh tē rrish vetëm dhe do tē fluturosh nga një kujtim te tjetri...

...Rrasa e malit ishte e lëmuar. Ajo përbëhej nga disa peta tē mëdha, gurësh, që qëndronin njëra mbi tjetrën. Shiu, dielli, era e kishin lëmuar e zbardhur kaq shumë, sa nga larg ngjante e pamundur që njeriu tē qëndronte nē këmbë, mbi atë pjerrinë tē gurtë... Cilët ishin ata një-rëz që ngjiteshin nëpér rrasën vigane tē malit? Ku shkonin? C'donin? Mos ishte me ta edhe Dini?... Ja ku filloji tē breronte shiu. Një shi i gëzuar, kokërrmadh, që kërcente mbi rrasën. Pastaj shiu u dendësua. U dendësua, dhe njerëzit u zhdukën. Rrjeta e shiut zuri tē bridhete me vrap tē çmendur nga kreu i rrasës vigane deri në fund. Bridhete e bridhete pa pushim. Pastaj pikëzat zunë tē kërcenin mbi shkëmb, dhe ngjante se shiu ngrihej nga poshtë lart. Pikëzat u shumuan. U zbardhën. U bënë tē tymta. Tërë rrasën e gurtë e mbuloi një mjegull qumësh-tore, që filloi tē lëvizte e ngathët drejt lartësisë. Ngelën

mbi shkëmb vetëm disa fije të holla, delikate, që nga çasti në çast do të shkëputeshin edhe ato... Papritur, nga një kënd i rrasës së gurtë në tjetrin u hap një ylber i madh gjithë ngjyra, plot shkëlqim... Delira filloi të vraponte drejt ylberit. Flokët ia merrte era dhe krahët i shkonin nga pas, si krahë shpendi. Ndjeu një lehtësirë dhe ja, u çua fluturim... «Dini! Dini!» Ajo sillej nën harkun e ylberit. Ku ishte fshehur Dini? Ja ku ishte. Sa e pa, u sul drejt tij. Ai u lëshua me vrap në pjerrësinë e rrasës, dhe Delira i shkoi nga pas...

Në prehrin e Mariës trupi i Delirës hidhej herë pas here përpjetë nga ethet. Merrte frymë shpejt dhe fërgëllonte me forcë. Maria përpinqej ta qëtësonte.

Pastaj Delira u qëtësua, hapi sytë dhe e pa e lodhur Marien.

— Ku është Dini? — pyeti dhe sakaq humbi përsëri.

Maria e lëshoi me kujdes mbi jastëk dhe i ngjiti me ngut shkallët. Sapo e panë, në fytyrat e burrave ra një hije e zbetë. Ata e përbajtën veten. Vështrimet e ftotë binin me ngulm mbi Marien. Dini, duroi sa duroi po, më së fundi, u çua në këmbë, u mbështet pas murit dhe, dyllë i verdhë, pyeti:

— Ç'ka ndodhur?

— Ajo... është keq...

— Ulu, — i tha Pali, — pi një gotë ujë dhe mos vër kujën.

Në mes të heshtjes u dëgjua kënga e gëzuar që vin te andej tutje, pastaj duartrokitjet e gjata dhe thirrjet e gëzuara të fshatarëve. Pastaj ushtoi përsëri muzika.

Maria nuk lëvizi nga vendi. Foli me vendosmëri:

— Ta hipim sipër, burrë, nuk është vonë...

— Mbylle gojën!

— Ta hipim sipër, Pal! — përsëriti Maria me të njëtin ton.

Fytyra e Palit u zbeh.

— Mbylle gojën, tē thashë! — thirri ai dhe përplasi pëllëmbën mbi sofër.

Maria u skuq dhe sytë i nxorën shkëndija.

— Jo! thirri Maria. — Nuk do ta mbyll më gojën... Tani do tē na bindësh ti ne. Delirën do ta hipim sipër!

— Kurrë, — tha prerazi Pali, — sa tē jem unë gjallë!...

Tonini mbeti i shushatur.

— Dëgjoje, Marien, Pal, — i tha ai.

Po Pali mbushi gotat dhe piu me fund disa radhazi.

Dini lëvizi ngadalë, si tē ishte i përgjumur, po, me tē arritur në mes tē dhomës, eci me nxitim drejt derës. Pali e pa.

— Ku shkon kështu?

Dini nuk u përgjigj.

IX

Të gjitha lëvizjet Dini i bëri si nëpër èndërr.

Hapi derën e bodrumit dhe hyri brenda, duke ndier një boshillëk tē madh në stomak. U afrua me hap tē nga-thët drejt shtratit dhe qëndroi mbi kokën e Delirës. E kishte zënë gjumi. Krahët i kishte nxjerrë jashtë, kokën e kishte varur mënjanë dhe flokët i mbulonin një pjesë tē fytyrës. Dini ia largoi flokët e butë dhe pa se qe mbuluar nga djersët. Merrte frymë thellë, shpejt dhe trupi, në çdo frymëmarrje, i lëkundej sikur sforcohej nga mundimi dhe herë pas here i shkundej nga një e dridhur e papritur.

— Delira! — i foli Dini me zë të butë. U përkul mbi tē dhe i foli përsëri.

— Delira!

Ajo përsëri nuk dëgjoi.

«Ka rënë në gjumë tē thellë, — mendoi. — Në gjumë nuk ndien dhembje dhe nuk ka frikë». U përkul, e puthi në faqen e ftohtë dhe në çast i shkoi ndër mend që ndoshta ky mund tē mos ishte tamam gjumë. Ndjeu t'i shkonin morrnica. «Pse merr frymë kështu?... Sikur nuk ngopet me ajër... mos i rëndon guna...» Ai ia largoi gunën. Një mallëngjim i thellë e pushtoi, kur vuri re që ajo i përpëliti qepallat dhe e pa atë si një fëmijë. Më shumë se çdo gjë tjetër vështrimi i saj shprehte dashuri.

Ai i buzëqeshi.

— Delira, — i pëshpëriti te veshi, — Delira!...

Zëri i tij kumboi i ëmbël e i dridhur.

— Dini! — pëshpëriti edhe ajo. — Ulu pranë meje.

Ai u ul në anë tē shtratit tē drunjtë, dhe ajo ia mori duart e ia përkëdheli. Një copë herë qëndruan në hesh-tje. Nga jashtë vinte melodia e gëzuar.

— Ata po këndojnë, — tha ajo.

— Po, Delira.

— Festojnë lindjen e fëmijës sonë.

— Po, Delira.

Ata përsëri heshtën. Dinit iu mblodh në grykë nga shërimi. Mezi u kapërdi.

— Delira! — i foli ai dhe u zbeh. — Unë nuk doja që ti... tē qëndroje... në bodrum...

— E di, Dini...

— Nuk kisha ç'ti bëja babës, se ai...

— Nuk ka gjë, Dini... ai është fanatic... i mbytur nga zakoni... por zemrën... e ka tē mirë... Edhe ai... vuau...

— Delira! Unë të dua shumë... shumë...

Ajo buzëqeshi, po sytë ende i mbante gjysmë të myllur.

Dini doli jashtë. Në ahur kali hingëlliu dhe rrahu tokën me këmbë, sikur ta ndiente që i zoti do t'i shkonte pranë. Ai i hodhi dorën në qafë dhe i përkëdheli kokën...

Në mbrëmjen e butë të vjeshtës kishte rënë lagësh-tira. Anembanë hapësira ishte mbushur me aromën e ëmbël, të parfumuar të barit dhe të luleve. Nëpër qetësinë e thellë të fushës dëgjoheshin cinxërimat nanuritëse të qindra insekteve. Dy mëllenja, kushedi pse, u frikësuan, lëshuan klithma të mprehta dhe, duke rrahu krahët gjithë zhurmë, dolën nga një gëmushë e u futën në një tjetër. Nga majat e maleve kullonte një ngjyrë e thellë blu që dalngadalë, po shtrihej në tërë fshatin. Nëpër qiellin ku kishin dalë yjet e para të zbeta, fluturuan lart, shumë lart, ca zogj të vonuar, zërat e të cilëve rrëzoheshin në fushë si nga një botë tjetër. Kali ecte ngadalë duke tundur kokën. Flegrat e hundës i hapeshin shumë, sikur deshi të thithte sa më tepër aromën e luleve e të barit, dhe turfullonte. Pastaj, uli kokën, e çoi përsëri lart dhe lëshoi një hingëllimë të gjatë, të dridhur, gjithë gëzim, që fluturoi nëpër ajër. Dini u përpoq ta qetëson-te. Ai donte të ecte në heshtje.

Megjithëse qe larguar shumë, akoma dëgjohej melodia e gëzuar.

«Vazhdojnë», tha me vete dhe iu kujtua një ngjarje e largët... Pat shkuar me Delirën të mblidhët lajthi në pyll...

Anës lumit të vrullshëm dhe të kthjellët, që kalonte midis shpateve të maleve, ata panë një grup gjeologësh që kishin ngritur çadrat. Njëri prej tyre kishte dalë

në hyrje tē çadrës, ishte ulur nē stol dhe i binte fisarmonikës. Këta tinguj, nē atë vend tē largët, midis bjeshtëve, tē dukeshin pakëz tē çuditshëm dhe tē nguleshin nē zemër. Dini me Delirën vazhduan rrugën më tej, po për një kohë tē gjatë nuk mundën ta harronin atë melodi.

Pastaj u futën nē pyll dhe u mbuluan nga freskia. Papritur, para tyre doli përroi. Ishte i ngushtë, po i thellë dhe aq i rrëmbyeshëm, sa dukej i bardhë nga shkuma. Dini u hodh tej. Matanë mbeti Delira. Ajo deshi tē zbathej dhe tē kalonte nëpër ujë, po Dini i foli:

— Jo, se tē merr me vete... Kapérceje!

Delira e pa përroin mëdyshas.

— Ke frikë? — e ngacmoi Dini.

Ajo u largua pak hapa dhe u bë gati tē hidhej.

— Sa tē numëroj tre, hidhu!

Dini filloi tē numëronte, dhe ajo mori frymë thellë.

— Hidhu! — i thirri Dini, dhe ajo e kapérceu përroin.

Dini e kapi fluturim për krahësh. Ajo u mbështet nē kraharorin e tij dhe atëherë ai ndjeu se zemra i rrihte fort dhe shpejt. Qe skuqur e tëra.

Pastaj ata u çliruan nga krahët e njëri-tjetrit, u panë sy më sy dhe befas ia dhanë tē qeshurit. Delira u lëshua me vrap, ndërsa qeshte me tē madhe, aq sa jehonte pylli. Nga pas bridhte Dini, po aq i lumtur sa ajo...

...Ai i mylli sytë, siç rrinte drejt nē kalë.

«Do tē jem dhe një herë aq i lumtur?»

Dhe u përkul i tëri, rrafsh me shpinën e kalit e ia shtrëngoi me tē dyja duart qafën.

«Kur tē lindë Delira, unë do tē jem njeriu më i lumbur nē botë...»

Ai e vari edhe kokën te qafa e kalit.

«Përse e bëre këtë... babë?»

Ca nga shtrëngimi, ca nga rënkim i hynte mu në vesh, kali u tërbua dhe u lëshua në pikë të vraptit.

Zbritën në fushë. Tutje dukej rrasha e malit vigan, nën atë dritë të zbetë, pa asnje bimë sipër, që, në atë vetmi të madhe, të bënte një përshtypje të thellë. Po Dini shkonte përpara, majë kalit, me atë ndjenjë dëshpërimi e turbullimi që e bënte të shihte çdo gjë si nëpër èndërr. Pastaj u duk lumi. Rridhte i qetë, me reflekse të argjendta, me gurgullimën e përjetshme që përhapej valë-valë mbi majat e bardha.

Kali filloi të bridhte me trokth. Dini u kap pas frejt dhe e nguci të bridhte akoma më shpejt. Për një gjysmë ore duhej të arrinte në fshatin matanë. Do të qëndronte fare pak dhe do të kthehej shpejt me... si e quanin... prit... ë, tamam, Dava... do ta merrte me vete... Po sikur të mos e gjente në shtëpi?

Kali hyri në lumë, e kaloi atë në vah dhe, sa doli në një luginë që hapej midis një vargu kodrash, u lëshua revan...

Ndërsa po lidhte kalin te ftoi, vuri re se në shtëpi që ndezur llamba dhe nga brenda vinin të qeshura të gëzuara. «Kudo njerëzit qeshin e gëzojnë», mendoi Dini dhe përsëri iu duk se halli që kishte në shtëpinë e tij, ishte i tillë, që njerëzit nuk do ta kuptonin.

Hapi derën dhe u fut brenda. Hodhi sytë dhe pa që në dhomë ishin ulur shtatë vetë: plaku, plaka, djali, nusja, dhe tre fëmijë. Po piqnin misra të njomë dhe po bisedonin me atë kënaqësi që kuptohet vetëm nga njerëzit që vijnë nga jashtë dhe kanë ndonjë hall.

Fytyra e zverdhur dhe tërë paraqitje tregonin se ishte i dëshpëruar, sa nuk mbante më. Menjëherë njerëzit pushuan së qeshuri dhe prenë bisedën. Djali u çua

vrik dhe i tha Dinit të ulej. Dini foli i lodhur nga pragu i derës:

— Kam ardhur për një hall të madh... Nuk është në shtëpi Dava?

Një copë herë u bë qetësi, pastaj plaka, ndërsa rrotullonte një misër të madh në prush, i tha:

— Përsëri për Davën... pa u ulur mirë vajza...

Nuk e mbaroi mendimin se plaku i hodhi një shikim të rreptë.

— Ulu pak të çlodhesh, se ja, këtu është Dava, — tha plaka me zë të shtruar.

— Sapo u kthye nga një lindje, — foli nusja.

Dini u ul i menduar në një kënd të dhomës.

— Nuk keni mami në fshatin tuaj? — e pyeti nusja.

Dini tundi kokën.

— Mos u mërzitni, — ndërhyri plaku. — Edhe ju do të keni... Në fillim gratë nuk e thërritnin Davën, nuk i besonin, edhe ajo qante... Mos u mërzit, i thosha unë, duro, se të gjitha do të rregullohen. Dhe ja, tani nuk i del koha të marrë frymë...

— Po më mbetet vajza pa martuar, kaq punë ka, — tha duke pshëritirë plaka.

— Hë, moj ti, — tha djali. — Mjafton të hapë gojën Dava, se njëqind trima do të vriteshin, kush ta merrte më parë.

Fëmijët rrahën shuplakat dhe përsëritën se trimat do të vriteshin ma shpata për Davën, kaq e mirë dhe kaq e bukur ishte ajo.

— Është keq? — pyeti nusja.

Dini çoi kokën, se nuk e kuptoi pyetjen.

— Nusja jote është shtatzënë? — e pyeti përsëri e reja.

— Po, — u përgjigj Dini.

— Të parin e ka?

Dini pohoi me kokë. Plaku i dha një misër të pjekur. Dini shkoqi ca kokrra.

— Të parin, — u përgjigj pas një copë here.

— Të gjitha tremben shumë me të parin. Pastaj mësohen. Mos u bë mërak... Sa shumë qenke shqetësuar! Ajo duhet të gëzohet që ti e do kaq shumë.

«Sikur ta dinin këta që babai e ka zbritur Delirën në bodrum, kushedi si do të më shikonin... Po sikur, gjatë kësaj kohe, — i shkoi papritur ndër mend Dinit, — t'i ketë ndodhur ndonjë gjë Delirës?» Ai u zverdh dhe u pushtua nga një ndjenjë padurimi. I dukej se kishte kaluar shumë kohë që kur kishte ardhur aty.

Te dera u dha Dava, një vajzë rreth 20-vjeç, mjaft e bukur, me flokë të drejtë, ngjyrë gruri, lëshuar mbi supe, me trup të lidhur dhe me një vështrim të guximshëm. Pa dashjen e tij, Dini u çua në këmbë dhe pati një ngërç. Po e shikonte me vëmendje dhe mundohej të buzëqeshte.

— Të kërkon ty, — i tha eëma dhe i tregoi Dinin.

Dava e pa Dinin për ca sekonda dhe, duke u kthyer nga i ati, tha me një zë të tingëllueshëm:

— Era e misrit të pjekur më shpoi hundët. Më jepni dhe mua një... Po ti, — iu drejtua Dinit, — pse nuk ulesh?

— Nuk pret koha, — tha Dini dhe tërë qenia e tij tregoi një ndjenjë padurimi.

Dava e kafshoi misrin dhe, duke e përtypur, e pa atë e menduar.

— Jam e lodhur, — tha ajo me një zë që Dinit, kuschedi pse, iu duk i njohur, — megjithatë...

«A thua nuk do të pranojë?», mendoi i trembur.

— Është shumë keq, — tha Dini, dhe qafa iu tendos përpara.

Ajo e lëshoi misrin në tavolinë dhe shikoi e menduar në një qoshe.

Dini psherëtiu thellë dhe u mundua të kapërdihej.

— Dava, — gati thirri, — ajo është shumë keq, shumë keq...

Vajza ktheu kokën dhe pa se Dini qe i tronditur së tepërmi.

— Gruaja jote është? — pyeti.

— Po. Ti e njeh mirë... e ke pasur shoqe fëmijnie... Delira...

Dava mbeti e habitur.

— Si??

— Ajo më ka folur shpesh për ty... Bashkë keni qëndruar në një bankë në fillore...

Dava u çua në këmbë.

X

Maria qëndronte pranë Delirës, kur dëgjoi në obori të kolliturën e një burri. Doli në prag të derës dhe pa se në oborr ishte sekretari.

— Si u ngryse, Marie? — e pyeti ai.

Maria e mbylli derën dhe u përgjigj me zë të pasigurtë:

— Mirë, faleminderit... po ju si jeni?

— Mirë, mirë, — tha sekretari. — Më thanë se ka ardhur Tonini...

— Po, erdhi... ka ardhur për punën e shtëpisë...

— Shumë mirë... Deshëm t'ju sillnim dy nga artistët e Tiranës, po menduan se nuk keni vend... Si është Delira? — pyeti papritur.

Maries i rrahu zemra me forcë.

— Presim! — u përgjigj ajo dhe përnjëherë shtoi:

— Dini shkoi të marrë maminë.

Sekretari ndezi një cigare.

— Kurse neve na thanë që e keni zbritur Delirën poshtë . . .

Maria u zverdh.

— Erdhi shërbyesi i kishës në shfaqje dhe pëshpëriti. E kishte dërguar prifti . . . Në qoftë se keni nevojë për gjë, mos u kurseni, në çdo orë ejani e më thërritni. . . Unë jam këmbëmbarë, — qeshi sekretari. — Delira do të lindë mirë e bukur një trim . . . Bëfshi natën e mirë! . . . Palit dhe Toninit shëndet . . . nuk po i shqetësoj . . . Natën e mirë dhe mos harro, më thërritni, po të keni nevojë . . .

Maria e pa si ecte i menduar nëpër muzgun e kaltër të mbrëmjes dhe ndiente një sëmbim në ndërgjegjje.

Kur hipi lart, Pali e pyeti se kush kishte ardhur. Ajo u kthyte drejt tij dhe, duke e parë në fytyrë, i tha prerazi:

— Sekretari.

— Ç'deshi? Pyeti gjë për Delirën? — dhe e pa me ngulm.

— I kishin thënë se Delirën e kemi zbritur në bëdrum . . .

— Kush i ka thënë? — pyeti Pali dhe u pre në fytyrë.

— Shërbyesi i kishës. E kish dërguar prifti në shfaqje . . .

Pali mbylli sytë dhe shtrëngoi dhëmbët. I ushtonin veshët.

— Dini do të kthehet tani, së shpejti, me maminë. E hipim sipër Delirën . . .

— Hajde, Pal! i foli edhe Tonini. — nuk shkojnë me këto zakone, perënduan njëherë e mirë, hajde ta sjellim nusen . . .

Pali kishte mbetur i ngurrosur.

— Mirë, pra, — tha Tonini, — zgresim bashkë, Marie . . .

Ai u çua në këmbë, por në këtë çast jashtë u dëgjuan zëra. Ishte kthyer Dini.

XI

Para se të futej në bodrum, Dava u kthyte nga Dini dhe e pa e çuditur:

— Këtu??!

Dini u turbullua.

— Unë nuk ndodhesha . . . kisha zbritur në qytet, — filloj të shpjegohej i nxituar Dini. — Babai . . . sipas një zakoni . . .

Dava hyri në bodrum. Tanimë errësira ishte dendësuar dhe flaka e qiririt ndriçonte zbetë vetëm shtratin e Delirës. Dava shkoi drejt saj. Pas e ndiqte majë gish-tave Dini. Ajo u shqetësua nga gërhima e mbytur e Delirës. Një copë herë qëndroi në këmbë, pranë Delirës, sikur nuk vendoste çfarë të bënte. Dalngadalë filloj të shquante fytyrën e saj, mbi të cilën kishte rënë zbetësi.

— Po fle! — pëshpëriti Dini.

— Nuk po fle, — iu përgjigj ajo e shqetësuar.

Dini u drodh. Ç'kuptim kishte kjo? Ai priti me ankth ndonjë shpjegim tjetër, po Dava nuk foli më. Ajo ul në gjunjë, më pranë Delirës dhe ndjeu një keqar-dhje të madhe.

— Lira, shpirt i motrës, si qenke katandisur kësh-

tu!... E zeza ti, sa ke vuajtur!... Ah, sikur ta kisha ditur ç'po ndodhte me ty... — dhe e mbyti ngashërimi.

Dini e preku në sup. Dava ktheu kokën dhe pa se fytyra e Dinit shprehte frikë.

— Ç'është... — i tha, ndërsa me vete mendoi: «Ç'vlen pendimi, kur e keqja është bërë...»

Dini pati një lëvizje të pandërgjegjshme të trupit, dhe muskujt e fytyrës iu shtrembëruan, sikur befas ta kishte goditur dikush me forcë. Pastaj e zuri Davën përkrahу dhe e shtrëngoi fort, sikur donte ta detyronte të fliste. Ajo u çua në këmbë dhe e pa në sy, me ngulm. «Tani i vjen keq, lutet, është gati t'ia plasë të qarit, po atë e la, ama, tërë ditën të torturohej nga ethet në bo-drum... Sa para bën tani të tregosh kujdes, kur me orë të tëra ajo nga dhembja e frika ka kafshuar jastë-kun?...»

— Mjaft! Gjithë jetën do të të vijë turp nga sjella jote.

— Po ti, — i tha me zë të dridhur Dini, — a nuk mund t'i bësh gjë... nuk mund ta ndihmosh? Të lutem shumë!...

Dava, në ato çaste, ndjeu dëshirën ta shtynte tej.

— Mos u vonuam? — pyeti përsëri ai i shqetësuar.

Dava ia zuri kokën Delirës dhe ia shkundi. Pastaj e goditi me dy shuplaka fytyrës.

— Ç'bën kështu? — thirri i shastisur Dini dhe donte t'i mbante duart, po ajo e shtyu paksa me përbuzje...

Për një çast Delira i hapi sytë dhe e pa Davën me një vështrim të përhumbur.

— Shpirt i motrës! Shpirt i motrës!... Më njohe? Ja ku erdha, jam unë, Dava.

Ajo u kujtua se nuk duhej të humbiste më asnjë minutë.

— Çohu! — i tha Dinit me zë urdhërues. — Merre Delirën në krah e hajde të ngjitemi sipër!

Dini iu bind menjëherë. E rrëmbeu Delirën në krahet muskulozë dhe eci pas Davës. Zemra i rrihte fort. Hapat i lëshonte të rëndë dhe i pëlqente kur dërrasat e vjetra kërcitnin nën peshën e tij. Ai shikonte Davën, me trupin e saj të drejtë, fidan, tek ngjitej nëpër shkallë dhe rrezet e hënës që i binin mbi shpinë, duke krijuar rrëth saj një kurorë drite. Me të ecurin e saj të sigurtë, nën atë kurorë drite, ajo ngjallte shpresë e gjëzim.

E hapi derën me forcë, dy kanatesh dhe vështrimin gjithë xixa e hodhi nga qoshja e dhomës, ku ishin ulur Pali me Toninin. Nuk i përshëndeti, nuk tha asnjë fjalë, veçse e nguli shikimin e saj shpues në sytë e Palit, që nuk lëviznin nën vetullat e trasha e të bardha. Maria u çua në këmbë. Pali lëvizi nga vendi. Tonini ishte hutuar plotësisht.

— Fol! — i tha Davës Pali. — Ç'kërkon në shtëpi-në time?

— Edhe po pini! — u tha me përbuzje të thellë. — Ndërsa poshtë latë nusen të vuante.

Njerëzit shtangën. Fytyra e Palit u bë dyllë e verdhë.

— Kush tha? — pyeti ai me zë të mbetur.

— Unë them, mamia.

Në dhomë hyri Dini me Delirën në krahë.

— E shikon tani, babë, e shikon? — foli me një zë të thatë, të vrazhdë. — Ja pasojat e zakonit...

Ai zuri të thërriste, ndërsa Delira dridhej në krahët e tij.

Pali ndjeu përsëri një të therur në bark, po i mblo-dhi forcat që të mos rrëzohej.

— Zbritni poshtë! — urdhëroi Dava. — Dhe pas-trojeni vendin.

Maria shkoi e i hoqi rrëmbimthi shishet e rakisë dhe mezetë, që dukeshin sikur kishin mbetur aty prej 40-50 vjetësh.

— Shtro dyshekun! Ndërsa ju zbritni poshtë... Pini sa të doni në bodrum...

«Këtë kam dashur dhe unë... po nuk munda», mendoi Maria.

Pali lëvizi me mundim nëpër dhomë. Krah tij ecte Tonini, në një gjendje hëtimi të plotë. Në prag të derës Pali qëndroi dhe pyeti:

— Mos ka ndonjë rrezik...?

Dava e pa me sytë e saj që të shponin dhe iu përgjigj pa urrejtje:

— Kam shumë frikë... Unë do të bëj çmos. Por kam frikë...

Ndërsa e shikonte plakun që rrinte i shtypur në prag të derës, atë e pushtoi përsëri zemërimi:

— Të gjitha pasojat nga ju erdhën... robëri të një zakoni të egër... Ju e çuat deri në këtë shkallë... Tani ç'kérkon, dilni jashtë! Jashtë!...

Si Dini, ajo ndiente dëshirën të shfrehej. Iu desh një copë herë që ta zotëronte veten. Shkoi pranë Delirës që ishte shtrirë në dyshek dhe po përpëlistë qepallat.

«Po e merr veten», tha me vete dhe një avull i ngrohtë i përshkoi trupin.

— Delira! — i thirri. — Lira, dëgjon? Lira!

Ajo hapi sytë dhe e pa e hutuar.

«Do të më njohë», tha me vete dhe qeshi.

— Dava... ti qenke?

Dava e puthi në faqe.

— Unë jam, shpirt i motrës, unë... Ti, me siguri, më ke kërkuar... Të jam kujtuar?

— Po, — i tha Delira dhe shtrembëroi fytyrën.

Dini qe mbledhur kruspull në fund të dhomës. Ndërkaq Pali me Toninin zbritën shkallët të menduar.

— Kullën e re, — tha Tonini, kur patën zbritur në oborr, — do ta bëjmë sipas kohës, me dritare të mëdha. Të ketë dritë! Si thua ti?

— Po, — u përgjigj Pali dhe pushtoi kokën midis duarve.

Atij nuk i hiqej nga koka ky mendim: «Sikur Delira të vdesë, unë do ta pres qafën me briskun që shartoj pemët.»

XII

Lagështia e natës filloj t'u rrëqethte mishin të dy burrave që rrinin ulur në dy stola të vegjël, bri njëri-tjetrit, të heshtur e të menduar. Tutje, andej nga ara me misër, dikush kishte ndezur zjarr dhe herë pas here thërri-stë pér të trembur derrat e egër. Nën dritën e yjeve dhe të hënës, nëpér atë hapësirë ngjyrë blu të çelët, ndihej një pëshpëritje e kthjellët, sikur mijëra gishta përkëdhelnin flokët e verdhë të pemëve. Filloj të fryente era e natës, një erë e lagësht.

— Po mërdhih! — tha Tonini dhe u mblodh më mirë me xhaketë. — Ti nuk mërdhih?

Pali nuk dha përgjigje. Qëndronte i ngrysur, si një copë gur i murmë dhe shikonte vazhdimisht në një pikë.

— Ti ke frikë? — e pyeti Tonini, ndërsa e shikonte që rrinte i shtangur. — Mos u tremb... Gjithçka do të shkojë mbarë... Unë kam këmbë të mbarë...

Pali përsëri nuk foli. Po Tonini nuk e duronte heshjen e gjatë. Ai donte me çdo kusht që Pali të fliste.

— Hajde pimë, — i tha. — Ty po të ngrin gjaku.

I afroi gotën e rakisë, po Pali nuk pranoi të pinte.

— Bëj si të duash! — i tha Tonini, i zemëruar dhe piu vetë.

Midis tyre ra përsëri heshtje shtypëse. Një copë herë Tonini piu me dëshirën që të trullosoj, po, për çudinë e tij, ai ndihej i kthjellët.

Befas, në qetësinë e thellë të natës, u dëgjua një britmë.

— Dëgjon? — pyeti Tonini.

Pali u gjëzua. Pastaj përkuli shpinën. Tonini e pa dhe u tremb: «Mos po i bie pika?»

— Ç'ke? — e pyeti i preokupuar. — Ke nevojë përgjë? ... Ta thérres Marien? ...

— Jo ... asgjë ... Kështu më qëllon ndonjëherë ... do të kalojë ... — Dalngadalë drejtoi shpinën dhe mori frymë thellë.

— Dëgjo! — i tha përsëri i gjëzuar Tonini. — Më në fund ...

Fytyra e plakut u shtrembërua, sapo dëgjoi një zë të mprehtë që e shpoi tej e përtej qetësinë e natës.

— Po ajo... ajo... — tha Pali.

Papritur u çua dhe ngriu në këmbë.

— Bodrumi, — tha. — A do të vish ta shohësh sa mirë e pata rregulluar?

— Lëre tani atë muhabet, — i tha Tonini dhc e zuri për krahu. Hajde, ulu.

— Më beso që një muaj të tërë e kam pastruar me rrënjenjë.

— Asgjë e keqe nuk ka ndodhur...

— Jo ... jo ... Ka ndodhur ... dhe fajin e ka bodrumi.

— Fajin e ka zakoni, — i tha Tonini, që nuk po e duronte belbëzimin e plakut. — Të gjitha shtëpitë janë

me bodrum, edhe shtëpinë e re unë do ta ndërtoj me bodrum... Si është e mundur që ti paske mbetur me sýmbyllur? Kanë ardhur kohëra të tjera, Pal, fryjnë erëra të tjera...

Pali u ul përsëri në stol dhe e ndjeu veten të fyter e të poshtëuar. Kishte mbetur vërtet prapa botës.

Papritur i rrodhën lotë. Ai nuk deshi kurrsesi që Tonini ta shikonte, prandaj u çua, e shtyu atë tutje dhe shkoi e u fut në këndin e errët të bodrumit. U ul gërmuq e zuri të qante si fëmijë.

— Babë, Delira lindi!... Babë, a dëgjon?

Njerëzit e gjëzuar dolën te shkallët, bënin zhurmë, qeshnin, ndërsa Pali qante me zë, si fëmijë, duke ndier nevojë të mbetej aty, i vetmuar, akoma edhe për një kohë të gjatë.

E P I L O G

Një paradite pranvere, në një stol, nën bajamet e lulëzuara, ishte ulur një plak me flokët krejt të bardhë, që po zburonte me brisk një shkop thanc. Pranë tij, në gjunjë, ishte ulur një vajzë e vogël me flokë të verdhë, buzë të kuqe, sy të kaltër dhe me një lëkurë të holle, të butë, ngjyrë trëndafili.

— Gjysh! — foli vajza me një zë të ëmbël. — Për vete po e bën shkopin me lule?

— Po, bijë.

— Përse e do shkopin, gjysh?

— Që të mbështetem, bijë. Gjyshi lodhet shpejt tanë. Tutje u dukën Delira me Dinin. Pastaj u dëgjua kënga e fshatarëve që po zbritnin poshtë. Pas tyre u vunë edhe Dini me Delirën. Vajza u çua majë gishtave, t'i ndiqte me vështrim.

— Ku po shkojnë ata, gjysh?

— Të hapin kanalin, bijë.

— T'ua çoj unë bukën në drekë?

— Do t'ua çojmë bashkë.

Ajo e përqafroi fort.

— Ke qenë ndonjëherë prift, ti, gjysh? — e pyeti pa pritur.

— Çfarë?! u çudit plaku.

— Po unë ku kam lindur, në bodrum?... Ermira më ka thënë...

Plaku u trondit.

— Si e beson këtë?! — e pyeti plaku, i zverdhur në fytyrë.

— Oh, jo! Unë u zura me Ermirën. Unë e di që ti më do shumë. Edhe unë të dua shumë, shumë, gjysh.

Plakut iu mbushën sytë.

— Unë kam luajtur me Ermirën symbyllazi në bodrum... Ai është shumë i pastër.

— Mos luaj më aty, moj bijë, ajri është i rëndë...

Plaku u çua në këmbë dhe i tha vajzës të shëtitnin. Dhe të dy, zënë dorë për dore, filluan të ecnin ngadalë, nën kurorat e luleve të bajameve. Thëllëzat e fshehura nën bar, të trembura, çoheshin lart me turfullimë. Në-për degë këndonin gardalinat. Në qiellin e kaltër, të kthjellët, fluturonin duke bërë lloj-lloj figurash dallëndyshe të bukura.

— A më mban kalapiç, gjysh?

Plaku u ul në gjunjë.

— Yyy, sa e madhe u bëra!... Kur piqen qershítë, gjysh?

— Kur t'u vijë koha. Gjithçka piqet kur i vjen koha.

— Ti i ke mbjellë bajamet, gjysh? Njerëzit thonë «bajamet e xhaxhi Palit».

— Po, bijë.

— Gjysh, shtëpinë e vjetër atje poshtë e kemi pasur?

— Po, bijë.

— Pse e prishëm? Ishte si kishë?...

— Jo, u vjetërua.

Papritur vajza e shtrëngoi në qafë.

— Gjysh, më ul poshtë, shpejt!

Plaku e uli vajzën dhe ajo, duke ecur në majë të gishtave, me kujdes, duke e tendosur trupin përpara, shkoi të kapte një flutur të madhe, gjithë ngjyra, që qëndronte krahëhapur mbi një lule. Por, sapo vajza zgjati dorën, ajo fluturoi. Atëherë ajo bërtiti:

— Kape, gjysh, kape!

Dhe gjyshi u hodh ta kapte, po flutura bëri një hark mbi kokën e tij, pastaj një tjeter... Ai përqëndroi ternerë vëmendjen që të mos i dridheshin duart, po flutura, si për t'u tallur, i kaloi para hundës dhe, fiu, u ngjit lart.

— Ah, mor gjysh!

Vajza bridhte gjithë gëzim, rrihte shuplakat, qeshte sa e trempte fluturën, po gjyshi u dwersit, u lodh dhe u ul shesh. Pastaj u shtri dhe mbylli sytë. Kur i hapi, nuk e pa vajzën.

— Arlinda! — i thirri. — Arlinda, moj!

Dhe filloi të shikonte përreth i shqetësuar. Atë çast vajza nxori kokën nga një kaçubë, ia bëri «ku-ku» dhe u lëshua me vrap drejt tij.

— Gjyshi im! Gjyshi im! — thirri dhe iu hodh në qafë.

Maria kishte dalë në prag të derës dhe po i shikonte.

«Sa shumë e do!», tha ajo dhe iu kujtua se si vite më parë, po kështu, ai përkëdhelte Dinin kur ishte i vogël.

— Tani unë po shkoj të luaj, — i tha ajo gjyshit dhe u lëshua në pikë të vraptit.

Puhiza ia merrte flokët e verdhë dhe ia çonte mbi gjunjë fustanin e gjelbër. E tëra ajo ishte një gëzim që fluturonte. Gjyshi e ndoqi me sy i mahnitur. Pranë tij u ul, pa bërë zhurmë, Maria.

— Iku, — i tha ai.

— E pashë kur bridhte, — tha Maria. -- Ku shkelte këmba e saj, vendi ndriste.

— Zbriti poshtë, nga shtëpia e vjetër ...

— Është e vogël dhe do të luajë.

— Atje ka shumë gurë, — tha Pali, — gurë të zinx... Mos e lër të luajë në bodrum... muret janë shkallmuar e janë tërë lagështi...

Maria nuk u përgjigj.

— Dëgjove? — e pyeti ai.

— Mirë, mirë... sa herë do të ma thuash këtë...

Harroje, të shkretën... Të shkuara të harruara.

Ndërkaq u dëgjua e qeshura e gjëzuar e Arlindës.

— Po qesh, — tha Maria. — E dëgjon si i këndon zemra?

Ata u çuan dhe ngadalë-ngadalë zunë të zbritnin poshtë, të mbuluar nga ngjyrat e pranverës.

— Më duket se po na thërret, — tha Maria.

— Ashtu më duket edhe mua, — tha Pali.

Ajri dridhej nga tingujt e gjëzuar. Ata shkonin drejt endrrës së tyre ...